

Drita Rudi, Donika Rudi-Berishaj, Rafet Rudi

EDUKATË MUZIKORE 4

Për klasën e katërt të arsimit fillor

Libri i mësuesit/es





Teksti “Edukatë muzikore për klasën IV”

“Edukata muzikore” për klasën IV është në përputhshmëri të plotë me kurrikulën e paracaktuar nga MASHT-i. Qëllimi themelor i tekstit është kultivimi i dashurisë ndaj muzikës. Në vazhden e kësaj përpjekjeje jepen informacione të reja, gjithmonë në pajtim me stadin e zhvillimit të përgjithshëm të nxënësit. Kujdes i veçantë i është kushtuar përmbajtjes së teksteve të këngëve që përfshihen në libër. Mu për këtë, përmbajtja e këtyre teksteve është e tillë, sa që jemi të bindur se ajo kultivon personalitetin e nxënësit dhe pasuron botën emocionale të tij.

Aktivitetet të cilat sugjerohen në tekstin *“Edukatë muzikore IV”*, janë të drejtuara në njohjen elementare të koncepteve muzikore, si: notave, pentagramit, shenjave të ndryshme muzikore, celësit etj., në një mënyrë tejet atraktive dhe gjithmonë të qartë.

Një kujdes i kushtohet zhvillimit të aftësisë për të kënduar, aftësisë për të luajtur në instrumente, aftësisë për të përjetuar muzikën, aftësisë për të krijuar etj. Të gjitha këto aktivitete, nxënësit do t’i zhvillojnë në dy mënyra: në formë individuale dhe në formë grupe. Në këtë mënyrë nxënësi zhvillon kompetencat individuale, por, njëkohësisht, përmes formës grupe, te nxënësi/ja zhvillohet aftësia për të bashkëpunuar - që është një rrugë e mirë e socializimit të tij/saj, e që përbën një prej komponentëve më të rëndësishëm në drejtim të formimit të përgjithshëm shoqëror.

Këndimi mbetet akoma një prej aktiviteteve kyçe për kultivimin e dashurisë ndaj muzikës. Përveç kësaj, përmes këndimit të këngëve të përzgjedhura në këtë tekst, ato zgjerojnë njohuritë e tyre për jetën, për virtytet njerëzore, për bukuritë e vendit të tyre, dhe për historinë e lavdishme të vendit të tyre.

Pjesë thelbësore dhe shumë e rëndësishme e tekstit janë: segmenti i dëgjimit muzikor, kreativiteti dhe gjithashtu mësimi e leximi i notave. Përmes listës së veprave të cilat sugjerohen për dëgjim, nxënësi do të ketë mundësi të njohë llojet e muzikës, të njohë krijuesit dhe performuesit e rëndësishëm, instrumentet muzikore dhe përfundimisht, te ai do të kultivohet dëshira për të dëgjuar muzikën dhe do të kultivohet dashuria që të jetë prore afër muzikës së mirë.

Nxënësi/ja, përmes këtij teksti, do të mësojë që të shoqërojë këngët të cilat ai/ajo i ka mësuar më parë. Këtë do ta bëjë me instrumente që disponon shkolla, por edhe me mjete të ndryshme të sajara në klasë, duke zhvilluar kështu edhe kreativitetin e tij/saj në shumë drejtime.

Autorët

1. **Këngë: Shtatori**
2. Bota e tingujve
3. Të mësojmë këndimin - solisti/ja dhe kori
4. Didaktike: Nota SOL-MI
5. Këngë: *Katër Stinët*
6. Pentagrami/aktivitet: Shëno notat muzikore me butonë
7. Të dëgjojmë: Edvard Grieg "Disponimi mëngjesor" (Peer Gynt)
8. Forma muzikore A B A/notat muzikore
9. **Këngë: Prilli piktor**
10. Piktura dhe muzika
11. Masa 2/4 & Ligjërime ritmik: Vjeshta
12. **Këngë: Fëmijët e Kosovës**
13. Vlerat e notave: Nota katërshe, nota tetëshe/nota gjysmë dhe nota e plotë
14. Flauti - të dëgjojmë: *Camille Saint-Saëns "Aviary"* (nga karnavali i kafshëve)
15. Masa ¾ & Notat dhe pushimet
16. Këngë: *Biçikleta*
17. Taktimi - Pushimi katërshe & Ushtrime Ritmike

18. Të luajmë & Të dëgjojmë: Antonio Vivaldi "Stinët" Krijimet muzikore
19. Muzika jonë popullore – « *Pranvera filloi me ardhë* »
20. Këngë: *Vit i Ri*
21. **Didaktike: Nota Do - Dordoleci - Elementet muzikore Shkalla C-DUR**
22. **Kitara** - Veprat e autorëve kosovarë për instrumentin e kitarës - Llojet e kitarave
23. Didaktike: Nota LA & Nota SI
24. Lahuta - të dëgjojmë: *Drinor Zymberi "Epos"*
25. **Këngë: Vendi im**
26. Didaktike: Nota FA & Nota RE
27. Dinamika - Shëno dinamikën
28. Këngë: *Muzikantët e vegjël*
29. Profesionet: Instrumentisti dhe këngëtari, kompozitori dhe dirigjenti

30. **Këngë: Kënga e nënës**
31. Të dëgjojmë: *Simfonia e 5-të e Beethoven-it* - aktivitet: "Gjeni përgjigjet"
32. Llojet e institucioneve: teatri, muzeu, salla koncertale dhe galeria
33. Llojet e muzikës
34. Këngë: *planetët*
35. Kompozitorët e vegjël
36. Të dëgjojmë: *Fahri Beqiri & Vinçenc Gjini* - të dëgjojmë: *Giora Feldman "Let's Be happy"*
37. Kanoni
38. Përgatitni koncert në klasën tuaj
39. Këngë: *Lamtumirë*
40. Të ndërtojmë instrumentet muzikore

Lënda-ët e fushës kurrikulare	TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE				Kontributi në rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës 2 (Klasa e IV - të).	
	PERIUDHA (I)		PERIUDHA (II)	PERIUDHA (III)		
	SHTATOR- TETOR	NËNTOR- DHJETOR	JANAR- SHKURT- MARS	PRILL - MAJ- QERSHOR	I	Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv 3, 4, 5, 6
Lënda: Edukatë muzikore	Këngët	Këngët	Këngët	Këngët	II	Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ 1,2,3,4,5, 6,7,8
	Lojërat muzikore	Krijimet muzikore	Elementet bazike të gjuhës artistike	Krijuesit dhe përformuesit	III	Kompetenca e të nxënit - Nxënës i suksesshëm 1,2,3, 4,5,7,8
		Elementet bazike të gjuhës artistike Elementet muzikore	Elementet muzikore Shkrim leximi Format muzikore	Veprat artistike Ngjarjet artistike		

		Shkrim leximi Format muzikore	Llojet e muzikës		IV	Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv
					V	Kompetenca personale – Individ i shëndoshë
						8
					VI	Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm
						2,6

PLANI DYMJOR:		Shtator – Tetor
VITI SHKOLLOR:		
FUSHA E KURRIKULËS:		ARTET
LËNDA :		EDUKATË MUZIKORE
KLASA :		IV
TEMA-T mësimore:	-K Këngët; -Lojërat muzikore	
RNK- Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:		
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit –Komunikues efektiv		
I.3Dëgjon në mënyrë aktive prezantimin e tjetrit dhe merr pjesë në diskutim ,duke u paraqitur me të paktën dy ndërhyrje ;pyetje, komente apo sqarime për temën e dhënë.		
I.4 Shpreh qëndrimin për ngjarjen apo për performancën dhe emocionet e veta që i ka përjetuar gjatë shikimit të një filmi, të një dokumentari të përshtatshëm për moshën e vet, gjatë leximit të një libri, një interpretimi muzikor, një ekspozite, një recitimi apo dramatizimi, në njërën nga format shprehëse, si: me të folur, me shkrim, me vizatim, me mimikë, me lëvizje etj.;		
I.5 Merr pjesë në organizimin e një shfaqjeje artistike në harmoni me moshën e vet, duke përdorur forma të ndryshme të të shprehurit.		
I.6 Identifikon personazhet kryesore të një tregimi, drame, flmi, kënge apo ndonjë ngjarjeje nga jeta, bën dallimin e tyre duke bërë një listë me vetitë që i pëlqejnë dhe që nuk i pëlqejnë tek ata, diskuton rreth tyre, performon rolin e njërit prej personazheve në bashkëveprim me moshatarë.		
II.Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ		
II.4 Zgjidh problemin dhe detyrën e dhënë nga gjuha, aritmetika, gjeometria, shkenca e natyrës, shoqëria ose fusha të tjera dhe jep një shembull e më shumë nga jeta e përditshme kur një qasje e tillë mund të përdoret në situata të ngjashme.		
II.5 Ndërton tekste, objekte, animacione apo gjëra të tjera në bazë të imagjinatës		

duke përdorur me kujdes udhëzimet dhe elementet apo materialet e dhëna;

II.6 Përshkruan dukurinë e caktuar (natyrore, shoqërore - historike) në njërin nga format shprehëse, duke veçuar ndryshimet që ndodhin apo kanë ndodhur në mjedisin që e rrethon e që janë rrjedhojë e kësaj dukurie.

II.7 Paraqet dhe arsyeton me argumente mënyrën e zgjidhjes së një problemi/detyrë të caktuar të fushave të ndryshme (matematikore, gjuhësore, të shkencave të natyrës, shoqërore, të arteve, shëndetësore... etj.) në kohëzgjatje prej 6-10 minutash.

II.8 Dallon lëndët, trupat, objektet, dukuritë natyrore apo shoqërore të dhëna në detyrë sipas karakteristikave (përbërjes, vetive, shndërtimeve apo pozitive në kohë e hapësirë dhe bashkëveprimet) të tyre.

Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm

III.2 Shfrytëzon burime të ndryshme të informacionit me rastin e përgatitjes së një teme të caktuar

III.3 Identifikon dhe krahason informatat e njohura me ato të panjohura për një temë, çështje apo ngjarje të caktuar duke përdorur teknika të ndryshme (p.sh., duke i shënuar me shenja të ndryshme).

III. 4 Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në burime të tjera për të realizuar një veprim, aktivitet apo detyrë konkrete që kërkohet prej tij/saj;

III.5 Krahason përparimin e vet me përvojën paraprake gjatë kryerjes së një detyrë apo një aktiviteti të caktuar.

Kompetenca personale – Individ i shëndoshë

V. 8 Bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjithë moshatarët (pavarësisht prejardhjes së tyre, aftësive dhe nevojave të veçanta) për arritjen e një qëllimi të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj);

Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm

VI.2 Shpreh, dëgjon dhe respekton mendimin e secilit anëtar dhe bashkërisht vendos për mënyrat e përfundimit të një aktiviteti të përbashkët;

RNF- Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:

- 1.1 Këndon individualisht dhe në grup, këngë e melodi sipas imitimit dhe notacionit muzikor me simbole (lule, flutura, katrorë etj.)
- 1.2 Ritmizon vargje, ritme me zë dhe me vegla muzikore sipas imitimit dhe notacionit muzikor me simbole;
- 1.5 Lëviz dhe vallëzon sipas muzikës së dëgjuar, tekstit dramatik ose mesazhit artistik që dëshirojnë të shprehin;
- 1.6. Krijon ritme e melodime të instrumenteve muzikore në bazë të ritmit të tekstit poetik;
- 2.1 Identifikon dhe përdorn mënyra origjinale dhe kreative elemente artistike për komunikim artistik të ideve e mesazheve të tyre, p.sh.: një dhe përdor mënyrat e ndryshme të trajtimit të elementeve shprehëse (ritmin, melodinë, harmoninë, formën, dinamikën, tempon, karakterin shprehës, vijat, ngjyrat, formën, lëvizjet, gjestet, emocionin etj.) për të komunikuar idetë personale, mesazhet, emocionet etj.
- 3.2 Emërton dhe dallon gjinitë dhe zhanret e ndryshme artistike
- 4.1. Çmon dhe vlerëson krijimet dhe performancat artistike (vetanake dhe të tjerë) dhe përdorur terminologji adekuate dhe koncepte të fushës

Tema-t mësimore	Rezultatet e të nxënit për temën mësimore RNL	Njësitë Mësimore	Koha e mësimore	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët tjera mësimore, me çështjet	Burimet
Këngët	Këndon dhe interpreton në instrumente (individuale dhe në grupe) sipas imitimit dhe notacionit simbolik (grafik) dhe sipas notacionit muzikor (kryesisht në C-dur). Këngët dhe meloditë e shoqërimet instrumentale trajtojnë	Shtatori (Zh) Bota e tingujve (Zh) Katërstinët (Zh) Katërstinët (P) Forma Muzikore/ Notat muzikore, melodia dhe ritmi (Zh) Masa 2/4 & Ligjërimitmik - Gëzim vjeshte (Zh)	9	Mësimdhënia dhe të nxënit me nxënësin në qendër dhe gjithëpërfshirja Mësimdhënia dhe të nxënit e diferencuar Mësimdhënia dhe nxënia e bazuar në kompetencat Mësimdhënia dhe të nxënit e integruar	Vlerësimi formativ	Gjuhë shqipe Matematikë Njeriu dhe natyra Edukata fizike, sportet dhe shëndeti Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm	Edukata muzikore 4 Dukagjini CD 4 http://krokotak.com/
Lojërat muzikore							

	tema të ndryshme të përshtatshme për moshën e tyre (për natyrën, shkollën, familjen, dëshirat, lodrat, stinët, festat etj). Shoqëron këndimin me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë simbas instruksioneve të mësidhënësit dhe në mënyrë kreative.	Vlerat e notave: Nota katërshe, nota tetëshe (Zh) Vlerat e notave: Nota katërshe, nota tetëshe (P) Dinamika & Shënodynamikën (Zh)					
--	--	---	--	--	--	--	--



	Luan lojëra të thjeshta muzikore, të shoqërua ra me këngë, të cilat kanë gjuhën shprehës e të përshtats hme me fjalorin e moshës së tyre, të përcjella me lëvizje trupore, e me vegla muzikore fëmijëror e dhe që trajtojnë tema te ndryshme , por edhe elemente didaktike të gjuhës artistike muzikore (ritmi,						
--	--	--	--	--	--	--	--

	melodia, vetitë e tingullit muzikor etj.). Luan lojëra të ndryshme ku sinkretizo het fjala, muzika, mimika, lëvizja, ana vizuale etj. (tematika e lojërave përshtate t me tematikat nga fushat e tjera mësimore për këtë klasë).						
--	--	--	--	--	--	--	--

	PLANI DYMUJOR:	NËNTOR – DHJETOR
	VITI SHKOLLOR:	
	FUSHA E KURRIKULËS :	ARTET
	LËNDA :	EDUKATË MUZIKORE
	KLASA :	IV
TEMA-T mësimore:	Këngët Krijimet muzikore Elementet bazike të gjuhës artistike Elementet muzikore Shkrim leximi Format muzikore	
RNK- Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:		
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit –Komunikues efektiv I.3 Dëgjonnëmënyrëaktiveprezantimetjetritdhemerrpjesënëdiskutim,dukeuparaqitur metëpaktëndyndërhyrje;pyetje, komenteaposqarimepërtemënedhënë. I.4 Shpreh qëndrimin për ngjarjen apo për performancën dhe emocionet e veta që i ka përjetuar gjatë shikimit të një filmi, të një dokumentari të përshtatshëm për moshën e vet, gjatë leximit të një libri, një interpretimi muzikor, një ekspozite, një recitimi apo dramatizimi, në njërën nga format shprehëse, si: me të folur, me shkrim, me vizatim, me mimikë, me lëvizje etj.; I.5 Merr pjesë në organizimin e një shfaqjeje artistike në harmoni me moshën e vet, duke përdorur forma të ndryshme të të shprehurit. I.6 Identifikon personazhet kryesore të një tregimi, drame, flmi, kënge apo ndonjë ngjarjeje nga jeta, bën dallimin e tyre duke bërë një listë me vetitë që i pëlqejnë dhe që nuk i pëlqejnë tek ata, diskuton rreth tyre, performon rolin e njërit prej personazheve në bashkëveprim me moshatarë.		
Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ		

II.5 Ndërton tekste, objekte, animacione apo gjëra të tjetra në bazë të imagjinatës duke përdorur me kujdes udhëzimet dhe elementet apo materialet e dhëna;

II.6 Përshkruan dukurinë e caktuar (natyrore, shoqërore - historike) në njërën nga format shprehëse, duke veçuar ndryshimet që ndodhin apo kanë ndodhur në mjedisin që e rrethon e që janë rrjedhojë e kësaj dukurie.

II.7 Paraqet dhe arsyeton me argumente mënyrën e zgjidhjes së një problemi/detyrë të caktuar të fushave të ndryshme (matematikore, gjuhësore, të shkencave të natyrës, shoqërore, të arteve, shëndetësore... etj.) në kohëzgjatje prej 6-10 minutash.

II.8 Dallon lëndët, trupat, objektet, dukuritë natyrore apo shoqërore të dhëna në detyrë sipas karakteristikave (përbërjes, vetive, shndërrimeve apo pozitive në kohë e hapësirë dhe bashkëveprimet) të tyre.

Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm

III.2. Identifikon dhe krahason informatat e njohura me ato të panjohura për një temë, çështje apo ngjarje të caktuara duke përdorur teknikat e ndryshme (p.sh., duke shprehur mendimet e tyre me shprehje të ndryshme).

III.3 Identifikon dhe krahason informatat e njohura me ato të panjohura për një temë, çështje apo ngjarje të caktuara duke përdorur teknika të ndryshme (p.sh., duke i shprehur me shprehje të ndryshme).

III.4 Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në burime të tjera për të realizuar një veprim, aktivitet apo detyrë konkrete që kërkohet prej tij/saj;

Kompetenca personale – Individ i shëndoshë

V. 8 Bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjithë moshatarët (pavarësisht prejardhjes së tyre, aftësive dhe nevojave të veçanta) për arritjen e një qëllimi të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj);

RNF- Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:

1.1 Këndon individualisht dhe në grup, këngë e melodi sipas imitimit dhe notacionit muzikor me simbole (lule, flutura, katrorë etj.);

1.2 Ritmizon vargje, ritme me zë dhe me vegla muzikore sipas imitimit dhe

notacionit muzikor me simbole;

1.5 Lëviz dhe vallëzon sipas muzikës së dëgjuar, tekstit dramatik ose mesazhit artistik që dëshirojnë të shprehin;

1.8 Krijon elemente origjinale në interpretimin e rolit të caktuar dhe paraqitjes skenike.

2.1 Identifikon dhe përdor në mënyrë origjinale dhe kreative elementet artistike për komunikim artistik të ideve e mesazheve të tyre, p.sh, njih dhe përdor mënyra të ndryshme të trajtimit të elementeve shprehëse (ritmin, melodinë, harmoninë, formën, dinamikën, tempon, karakterin shprehës, vijat, ngjyrat, formën, lëvizjet, gjestet, emocionin etj.) për të komunikuar idetë personale, mesazhet, emocionet etj.

3.1 Rinjeh vepra artistike ndaj të cilave është ekspozuar gjatë mësimit (rinjeh këngën, veprën muzikore, pikturën etj.).

3.2 Emërton dhe dallon gjinitë dhe zhanret e ndryshme artistike

3.4 Dallon, krahason dhe prezanton krijues performues dhe formacione interpretuese të zhanreve dhe stileve të ndryshme artistike në nivel kombëtar dhe global.

4.1. Çmوندhevlerëson krijimet dhe performancat artistike (vetanake dhe të tjerë) dhe përdor terminologji adekuate dhe koncepte të fushës

4.2 Komenton veprat artistike dhe shquan elementet karakteristike shprehëse të përdorura p.sh. ky vizatim është i mirë, ose forma e pemës nuk është mirë, për shkak se...ai/ajo këndoi mirë me ritëm por melodia nuk ishte e saktë etj. Mua nuk më pëlqen që ke përdor me tepri ngjyrën x, sepse...pra me gjykim kritik për atë që sa lejon moshën dhe aftësinë e tyre përjetuese e veprave).

Tema-t mësimore	Rezultatet e të nxënitor për temamësimore RNL	Njësitë Mësimore	Koha e	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët tjera mësimore, me çështjet	Burimet
Këngët	Këndon dhe interpreton në instrumente	* Katërstinët (ZH) * Solisti/ja dhe kori (Zh)	9	Mësimdhënia dhe tënxënitor me nxënësin në qendër dhe	Vlerësimi formativ	Gjuhë shqipe Matematikë Njeriu dhe	Edukata muzikore 4 Dukag

Krijimet muzikore	(individuali sht dhe në grupe) sipas imitimit dhe notacionit simbolik(grafik) dhe sipas notacionit muzikor (kryesisht në C-dur). Këngët dhe meloditë e shoqërimet instrumentale trajtojnë tema të ndryshme të përshtatshme për moshën e tyre (për natyrën, shkollën, familjen, dëshirat, lodrat, stinët, festat etj). Shoqëron këndimin	*Nota SOL dhe MI fq. 13,32 (Zh) * Pentagrame, çelësi muzikor dhe notat muzikore (fq. 11,12) (ZH) * Masa $\frac{3}{4}$ & Notat dhe pushimet (Zh) *Masa $\frac{3}{4}$ & Notat dhe pushimet (P) * Taktimi Pushimi katërshe (fq.	gjithëpërfshirja Mësimdhënia dhe të nxëniet e diferencuar Mësimdhënia dhe nxëniet e bazuar në kompetenca Mësimdhënia dhe të nxëniet e integruar	Vlerësim përmblendhës	natyra Edukata fizike, sportet dhe shëndeti Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm	jini CD 4
-------------------	--	--	---	-----------------------	--	-----------

Elementet muzikore Shkrimi Formatet muzikore	me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë simbas instruksioneve të mësidhënës dhe në mënyrë kreative. Improvizon në ritmet të ndryshme me zë dhe instrumente ritmike Ritmizon në mënyrë kreative vargjet, poezitë, gjëegjëzat etj. Realizon plotësimet muzikore (përfundimin e një melodie, pyetje-	36,37) (Zh) *Nota Do - Dordoleci; Elementet muzikore; Shkalla C-DUR (Zh) *Viti i Ri (Zh)					
---	--	---	--	--	--	--	--

	pergjege muzikore etj.). Këndon ose luan në instrumente fëmijërore ndonjë krijim origjinal të shkurtër (ritmik, melodik) me inkurajimin dhe ndihmën e mësimeve nësit. Dallon elementet themelore muzikore (ritmi, melodia dhe harmonia (dur-mol) ne këngët, lojërat dhe veprat						
--	---	--	--	--	--	--	--

	muzikore që ata i këndojnë në klasë dhe në të tjera vepra muzikore që dëgjojnë. Njeh dhe përdor notacionin muzikor bazik për (gjatësitë dhe lartësitë tingëllore (7 tingujt muzikor) për performim dhe krijim e shprehje muzikore. Identifiko n dukuritë muzikore ritmike e melodike, në këngët e kënduara dhe në veprat e dëgjuara. Perjeton						
--	--	--	--	--	--	--	--



	dhe dallon dy dhe tre pjesmërin ë në këngët e kënduara Krijon melodi të thjeshta (me zë dhe instrument e muzikore) në formën 2 dhe 3 pjesore të këngës.						
--	---	--	--	--	--	--	--

PLANI DYMUJOR:		JANAR – SHKURT - MARS
VITI SHKOLLOR:		
FUSHA E KURRIKULËS:		ARTET
LËNDA :		EDUKATË MUZIKORE
KLASA :		IV
TEMA-T mësimore:	-Këngët - Elementet bazike të gjuhës artistike Elementet muzikore Shkrim leximi Format muzikore -Llojet e muzikës -Instrumentet muzikore	
RNK- Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:		
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit –Komunikues efektiv		
I.3 Dëgjon në mënyrë aktive prezantimin e tjetrit dhe merr pjesë në diskutim, duke u paraqitur me të paktën dy ndërhyrje; pyetje, komente apo sqarime për temën e dhënë;		
I.4 Shpreh qëndrimin për ngjarjen apo për performancën dhe emocionet e veta që i ka përjetuar gjatë shikimit të një filmi, të një dokumentari të përshtatshëm për moshën e vet, gjatë leximit të një libri, një interpretimi muzikor, një ekspozite, një recitimi apo dramatizimi, në njërën nga format shprehëse, si: me të folur, me shkrim, me vizatim, me mimikë, me lëvizje etj.;		
I.5 Merr pjesë në organizimin e një shfaqjeje artistike në harmoni me moshën e vet duke përdorur forma të ndryshme të të shprehurit.		
I.6 Identifikon personazhet kryesore të një tregimi, drame, filmi, kënge apo ndonjë ngjarjeje nga jeta, bën dallimin e tyre duke bërë një listë me vetitë që i pëlqejnë dhe që nuk i pëlqejnë tek ata, diskuton rreth tyre, performon rolin e njërit prej personazheve në bashkëveprim me moshatarë.		

Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ

II.1 Identifikon veçoritë e përbashkëta dhe dalluese ndërmjet objekteve, qenieve të gjalla, dukurive apongjarjeve, të dhënave të detyrë; i paraqet ato për të tjerët përmes njërës nga format shprehëse.

II.2 Sqaron me anë të të folurit procedurën e zgjidhjes së një problemi matematikor (me veprimet themelore matematikore) me të cilin është ballafaquar apo ballafaqohet në një situatë jetësore.

II.4. Zgjidh problemin dhe detyrën e dhënë nga gjuha, aritmetika, gjeometria, shkencat e natyrës, shoqëria ose fusha të tjera dhe jep një shembull të më shumë nga jeta e përditshme kur një qasje e tillë mund të përdoret në situata të ngjashme.

II.5 Ndërton tekste, objekte, animacione apo gjëra të tjera në bazë të imagjinatës duke përdorur me kujdes udhëzimet dhe elementet apo materialet e dhëna.

II.6. Përshkruan dukurinë e caktuar (natyrore, shoqërore - historike) në njërën nga format shprehëse, duke veçuar ndryshimet që ndodhin apo kanë ndodhur në mjedisin që e rrethon e që janë rrjedhojë e kësaj dukurie.

II.7 Paraqet dhe arsyeton me argumente mënyrën e zgjidhjes së një problemi/detyrë të caktuar të fushave të ndryshme (matematikore, gjuhësore, të shkencave të natyrës, shoqërore, të arteve, shëndetësore... etj.) në kohëzgjatje prej 6-10 minutash.

II.8 Dallon lëndët, trupat, objektet, dukuritë natyrore apo shoqërore të dhëna në detyrë sipas karakteristikave (përbërjes, vetive, shëndetësive apo pozitive në kohë e hapësirë dhe bashkëveprimet) të tyre.

Kompetenca e të nxënës – Nxënës i suksesshëm

III.1 Parashtron pyetje që nxësin debat për temën/problemin e dhënë dhe u jep përgjigje pyetjeve të bëra nga të tjerët përmes njërës nga format e shprehjes.

III.2 Shfrytëzon burime të ndryshme të informacionit me rastin e përgatitjes së një teme të caktuar;

III.3 Identifikon dhe krahason informatat e njohura me ato të panjohura për një temë, çështje apo ngjarje të caktuar duke përdorur teknika të ndryshme (p.sh., duke i shënjuar me shenja të ndryshme);

III.4 Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në burime të tjera për të realizuar një veprim, aktivitet apo detyrë konkrete që kërkohet prej tij/saj;
III.5 Ndërton tekste, objekte, animacione apo gjëra të tjera në bazë të imagjinatës duke përdorur me kujdes udhëzimet dhe elementet apo materialet e dhëna.

III.7 Identifikon cilësitë e veta që i posedon dhe cilësitë e nevojshme që duhet t'i zhvillojë për të nxënë një detyrë apo aktivitetet të caktuar dhe për të bashkëpunuar me të tjerët.

Kompetenca personale – Individ i shëndoshë

V.8 Bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjithë moshatarët (pavarësisht prejardhjes së tyre, aftësive dhe nevojave të veçanta) për arritjen e një qëllimi të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj);

Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm

VI.7 Identifikon dy e me shumë organizime shoqërore dhe përshkruan (në formë të shkruar apo në ndonjë formë tjetër) mënyrat/mundësitë se si njerëzit e ndryshëm me përvoja të ndryshme mund të organizojnë diçka të përbashkët.

RNF- Rezultatet e të nxënës të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:

1.2 Këndon individualisht dhe në grup, këngë e melodi sipas imitimit dhe notacionit muzikor me simbole (lule, futura, katrorë etj.)

1.3 Krijon forma të ndryshme dy dhe tridimensionale duke përdorur teknika të ndryshme figurative dhe aplikative

1.5 Lëviz dhe vallëzon sipas muzikës së dëgjuar, tekstit dramatik ose mesazhit artistik që dëshirojnë të shprehin;

1.7 Krijon lëvizje origjinale kreative sipas muzikës, tekstit letrar ose situatës së caktuar; (vallëzim, dramë)

2.1 Identifikon dhe përdor në mënyrë origjinale dhe kreative elementet artistike për komunikim artistik të ideve e mesazheve të tyre, p.sh, njeh dhe përdor mënyra të ndryshme të trajtimit të elementeve shprehëse (ritmin, melodinë, harmoninë, formën, dinamikën, tempon, karakterin shprehës, vijat, ngjyrat, formën, lëvizjet,

gjestet, emocionin etj.) për të komunikuar idetë personale, mesazhet, emocionet etj.

3.1 Rinjeh vepra artistike ndaj të cilave është ekspozuar gjatë mësimit (rinjeh këngën, veprën muzikore, pikturën etj)

3.2 Emërton dhe dallon gjinitë dhe zhanret e ndryshme artistike;

3.3 Prezanton funksionin e disa institucioneve të ndryshme artistike

3.4 Dallon, krahason dhe prezanton krijues përformues dhe formacione interpretuese të zhanreve dhe stileve të ndryshme artistike në nivel kombëtar dhe global;

4.1.Çmondhevlerësonkrijimetdheperformancatartistike(vetanakedhetëtjetjërëve)du kepërdorurterminologjiadekuatedhekonceptetefushës

4.2.Komentonvepratartistikedheshquanelementetkarakteristikeshprehësetëpërdor urap.sh.:kyvizatimështëimire,oseformaepemës nukështëimire,përshkakseai/ajokënd oimirëmeritëm,pormelodianuk ishteesaktëetj.



Tema-t mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore RNL	Njësitë mësimor e	Koha e mësimore	Metodolog jia e mësimdhë nies	Metodolo g-jia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrik ulare	Burim et
--------------------	--	-------------------------	-----------------	--	--------------------------------------	---	-------------

Këngët	Këndon	*Nota LA/ Nota SI (Zh)	1 2	Mësimdhënia dhe të nxënimit me nxënësin në qendër dhe gjithëpërfs hirja	Vlerësimi formativ	Gjuhë shqipe Matematikë Njeriu dhe natyra Edukata fizike, sportet dhe shëndeti	Edukata muzikore 4
Elemente t bazike të gjuhës artistike	(individualisht dhe në grupe) sipas imitimit dhe notacionit simbolik(grafik) dhe sipas notacionit muzikor (kryesisht në C-dur). Këngët dhe meloditë e shoqërime t instrumentale trajtojnë tema të ndryshme të përshtatshme për moshën e tyre (për natyrën,	*Nota FA dhe RE (Zh) * Llojet e muzikës Lahuta - të dëgjojm ë: Drinor Zymeri "Epos"(Zh) *Vendi im (Zh) f.53 *Kënga "Fëmijët e Kosovës " (Zh) *Kënga "Fëmijët e Kosovës " (P)		Mësimdhënia dhe të nxënimit e diferencuar Mësimdhënia dhe të nxënimit e bazuar në kompetenca Mësimdhënia dhe të nxënimit e integruar	Vlerësim përmblerdhës	Arsimi për zhvillim të qëndrues hëm	Dukagjini CD 4
Elemente t muzikore Shkrim leximi Format muzikore							
Llojet e muzikës							

Instrumentet muzikore	shkollën, familjen, dëshirat, lodrat, stinët, festat etj). Shoqëron këndimin me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë simbas instruksioneve të mësidhënësit dhe në mënyrë kreative. Dallon elementet themelore muzikore (ritmi, melodia dhe harmonia (dur-mol) në këngët, lojërat dhe veprat muzikore që ata i	* Kitara (Zh) *Kënga e nënës(Zh) *Të ndërtoj më instrumente muzikore (U) Muzika jonë populllore - "Pranvera filloi me ardhë"(Zh) Muzika jonë populllore - "Pranvera filloi me ardhë"(P)					
------------------------------	---	---	--	--	--	--	--

	këndojnë në klasë dhe në të tjera vepra muzikore që dëgjojnë. Njeh dhe përdor notacionin muzikor bazik për (gjatësitë dhe lartësitë tingëllore (7 tingujt muzikor) për performim dhe krijim e shprehje muzikore. Identifiko dukuritë muzikore ritmike e melodike, në këngët e kënduara dhe në veprat e dëgjuara. Perjeton						
--	--	--	--	--	--	--	--

	dhe dallon dy dhe tre pjeshmëri në këngët e kënduara Krijon melodi të thjeshta (me zë dhe instrumente muzikore) në formën 2 dhe 3 pjesore të këngës. Dallon lloje të ndryshme të muzikës në shoqëri, përmes dëgjimit muzikor (p.sh. muzikë për vallëzim, muzikë për film, teater,						
--	---	--	--	--	--	--	--

	muzikë për fëmijë, muzikë për raste të ndryshme, muzikë festive etj.). Përzgjedh muzikën e përshtatshme për ngjarjet dhe situatat e ndryshme, shfaqjet në klasë, shkollë, komunitet etj. Përzgjedh muzikën e përshtatshme për poezitë dhe tregimet e ndryshme. Dallon ngjyrën tingëllore të instrumen						
--	--	--	--	--	--	--	--

	teve muzikore (popullore dhe klasike), përmes dëgjimit të veprave muzikore të përshtatshme për moshën e tyre. Identifikoni dhe dalloni instrumentet muzikore edhe vizualisht, sipas formës, madhësisë, ngjyrës etj. Krijoni instrumente muzikore ritmike me materiale recikluarë dhe organike (						
--	--	--	--	--	--	--	--



	marakas me oriz, misër, dajre te vogla etj.). Dallon instrumen tet për nga materiali ndërtues, burimi tingëllor (instrume nte të drunjta, të tunxhit, frymore me harqe etj.), mënyra e interpreti mit, ansamblev e që u përkasin etj.						
--	---	--	--	--	--	--	--

	PLANI DYMUJOR:	PRILL – MAJ – QERSHOR
	VITI SHKOLLOR:	
	FUSHA E KURRIKULË S:	ARTET
	LËNDA :	EDUKATË MUZIKORE
	KLASA :	IV
TEMA-T mësimor e:	- Këngët -Krijuesit dhe përformuesit -Veprat artistike -Ngjarjet artistike	
RNK- Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:		
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit –Komunikues efektiv		
I.3 Dëgjon në mënyrë aktive prezantimin e tjetrit dhe merr pjesë në diskutim, duke u paraqitur me të paktën dy ndërhyrje; pyetje, komente apo sqarime për temën e dhënë;		
I.4 Shpreh qëndrimin për ngjarjen apo për performancën dhe emocionet e veta që i ka përjetuar gjatë shikimit të një filmi, të një dokumentari të përshtatshëm për moshën e vet, gjatë leximit të një libri, një interpretimi muzikor, një ekspozite, një recitimi apo dramatizimi, në njërën nga format shprehëse, si: me të folur, me shkrim, me vizatim, me mimikë, me lëvizje etj.;		
I.5 Merr pjesë në organizimin e një shfaqjeje artistike në harmoni me moshën e vet duke përdorur forma të ndryshme të të shprehurit.		
Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ		
II.5 Ndërton tekste, objekte, animacione apo gjëra të tjetra në bazë të imagjinatës duke përdorur me kujdes udhëzimet dhe elementet apo materialet e dhëna.		
II.6 Përshkruan dukurinë e caktuar (natyrore, shoqërore - historike) në njërën nga format shprehëse, duke veçuar ndryshimet që ndodhin apo kanë ndodhur në mjedisin që e rrethon e që janë rrjedhojë e kësaj dukurie.		
II.7 Paraqet dhe arsyeton me argumente mënyrën e zgjidhjes së një		

problemi/detyrë të caktuar të fushave të ndryshme (matematikore, gjuhësore, të shkencave të natyrës, shoqërore, të arteve, shëndetësore... etj.) në kohëzgjatje prej 6-10 minutash.

II.8 Dallon lëndët, trupat, objektet, dukuritë natyrore apo shoqërore të dhëna në detyrë sipas karakteristikave (përbërjes, vetive, shndërrimeve apo pozitive në kohë e hapësirë dhe bashkëveprimet) të tyre.

Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm

III.1 Parashtron pyetje që nxisin debat për temën/problemin e dhënë dhe u jep përgjigje pyetjeve të bëra nga të tjerët përmes njërës nga format e shprehjes.

III.2 Shfrytëzon burime të ndryshme të informacionit me rastin e përgatitjes së një teme të caktuar

III.4 Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në burime të tjera për të realizuar një veprim, aktivitet apo detyrë konkrete që kërkohet prej tij/saj;

III.5 Krahason përparimin e vet me përvojën paraprake gjatë kryerjes së një detyre apo një aktiviteti të caktuar.

Kompetenca personale – Individ i shëndoshë

V.8 Bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjithë moshatarët (pavarësisht prejardhjes së tyre, aftësive dhe nevojave të veçanta) për arritjen e një qëllimi të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj);

Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm

VI.2 Shpreh, dëgjon dhe respekton mendimin e secilit anëtar dhe bashkërisht vendos për mënyrat e përfundimit të një aktiviteti të përbashkët;

RNF- Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:

1.1 Këndon individualisht dhe në grup, këngë e melodi sipas imitimit dhe notacionit muzikor me simbole (lule, flutura, katrorë etj.);

1.5 Lëviz dhe vallëzon sipas muzikës së dëgjuar, tekstit dramatik ose mesazhit artistik që dëshirojnë të shprehin

1.8 Krijon elemente origjinale në interpretimin e rolit të caktuar dhe paraqitjes skenike.

2.1 Identifikon dhe përdor në mënyrë origjinale dhe kreative elementet artistike për komunikim artistik të ideve e mesazheve të tyre, p.sh, njeh dhe përdor mënyra të

ndryshme të trajtimit të elementeve shprehëse (ritmin, melodinë, harmoninë, formën, dinamikën, tempon, karakterin shprehës, vijat, ngjyrat, formën, lëvizjet, gjestet, emocionin etj.) për të komunikuar idetë personale, mesazhet, emocionet etj.

3.1 Rinjeh vepra artistike ndaj të cilave është ekspozuar gjatë mësimit (rinjeh këngën, veprën muzikore, pikturën etj)

3.2 Emërton dhe dallon gjinitë dhe zhanret e ndryshme artistike;

3.3 Prezanton funksionin e disa institucioneve të ndryshme artistike;

3.4 Dallon, krahason dhe prezanton krijues përformues dhe formacione interpretuese të zhanreve dhe stileve të ndryshme artistike në nivel kombëtar dhe global.

4.1. Çmondhevlërëson krijimet dhe performancat artistike (vetanakedhetëtjtjerëve) dhe ke përdorur terminologji adekuate dhe konceptet e fushës

4.2 Komenton veprat artistike dhe shquan elementet karakteristike shprehëse të përdorura p.sh. ky vizatim është i mirë, ose forma e pemës nuk është mirë, për shkak se....ai/ajo këndoi mirë me ritëm por melodia nuk ishte e saktë etj. Mua nuk më pëlqen që ke përdorur me tepri ngjyrën x, sepse...pra me gjykim kritik për atë sa lejon mosha dhe aftësia e tyre përjetuese e veprave).

Tema-t mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore RNL	Njësitë mësimore	Koha e mësimore (orë)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare	Burimet
Këngët	Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grupe) sipas imitimit dhe notacionit simbolik (grafik) dhe sipas notacionit muzikor (kryesisht në C-dur). Këngët dhe meloditë e shoqërimet instrumentale trajtojnë tema të ndryshme të përshtatshme për moshën e tyre (për natyrën, shkollën, familjen, dëshirat, lodrat, stinët,	*Kënga “Prilli piktor”(Zh) *Dëgjim -Edvard Grieg “Disponimi mëngjesor” (Peer Gynt) (Zh) Piktura dhe muzika Flauti - të dëgjojmë : Camille Saint-Saëns “Aviary” (nga Karnavali i kafshëve) Profesion	11	Mësimdhënia dhe nxënia me nxënësin në qendër dhe gjithëpërfshirja Mësimdhënia dhe nxënia e bazuar në kompetencat Mësimdhënia dhe të nxënit e integruar Mësimdhënia dhe të nxënit e diferencuar Planifikimi dhe realizimi i çështjeve ndërkurrikul	Vlerësimi formativ Vlerësimi përmblendës	Gjuhë shqipe Matematikë Njeriu dhe natyra Shkathtësi për jetë Edukata fizike, sportet dhe shëndeti Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm	Edukata muzikore 4 Dukagjini CD http://krokotak.com/

Krijuesit

dhe përformuesit	festat etj). Shoqëron këndimin me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë simbas instruksioneve të mësidhënësit dhe në mënyrë kreative.-	et: Instrumentisti dhe këngëtari , kompozitori dhe dirigjenti Biçikleta Profesionet: Instrumentisti dhe këngëtari , kompozitori dhe dirigjenti <i>Simfonia e 5-të e Beethove</i> <i>n- it/Aktivitet: gjeni përgjigjet</i> Llojet e institucioneve: Teatri, muzeu, salla koncertale dhe galeria Planetët (fq. 74-		kulare			
Veprat artistike	Njih disa (10) krijues dhe performues nga veprat e dëgjuara muzikore.						
Ngjarjet artistike	Shpreh reagimin personal e emocional ndaj përjetimit të veprës artistike me disa fjali të thjeshta gjate bisedës dhe vrojtimit; me lëvizje, me mimikë, me mjete shprehëse të						

	tjera artistike etj. Çmon dhe vlerëson performancën /krijimet artistike vetanake dhe të tjerëve me fjalor e terma adekuate. Krijon shprehi për dëgjim te vazhdueshëm te veprave muzikore dhe për muzikim Përshkruan dhe komenton (me forma të ndryshme shprehëse: me gojë, me shkrim, me shprehje figurative, etj.), ndonjë ngjarje muzikore artistike, të përjetuar në familje, në shkollë, koncert, nga TV etj.	75) Të dëgjojmë : <i>Fahri Beqiri & Vinçenc Gjini dhe Giora Feldman "Let's Be happy"</i> Kënga "Lamtum irë"					
--	---	---	--	--	--	--	--

Fusha kurrikulare: Artet	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e Kurrikulës: Shkalla: II	Klasa: IV
Tema nga plani dymujor: Këngët		RNT: Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grup) sipas imitimit dhe nocionit simbolik (grafik). Këngët, meloditë e shoqërimet instrumentale trajtojnë tema të ndryshme, të përshtatshme për moshën e tyre (për natyrën, shkollën, familjen, dëshirat, lodrat, stinët, festat etj.). Shoqëron këndimin me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë, sipas instruksioneve të mësimdhënësit dhe në mënyrë kreative.	
RNK: I.4, II.6, III.4.			
RNF: 1.1,2, 2.1, 4.1			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Shtatori			
Fjalët kyçe: <i>muaji shtator, shkolla, nxënësit.</i>			
Rezultati i të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: dëgjon me vëmendje këngën; Ndjek melodinë me kënaqësi; Shpreh emocione.		Kriteret e suksesit: Dëgjon këngën duke shpjeguar emocionet që përcjell kënga; Këndon duke respektuar ritmin, intonacionin dhe rregullat e përcaktuara në këndim; Interpreton këngën me ndjenjë dhe emocion duke e respektuar me trupin drejt;	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: <i>Edukata muzikore, kasetofoni me CD.</i>			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore Gjuhë shqipe, Edukim për zhvillim të qëndrueshëm dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Shoqëria dhe mjedisi, Njeriu dhe natyra.			

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Pjesa hyrëse - mësuesi/ja bashkëbisedon me nxënës lidhur me fillimin e mësimi, për shkollën që fillon në muajin shtator, për rëndësinë e saj, duke u ndërlidhur me përmbajtjen e tekstit të këngës. Pyet nxënësit për përshtypjet që ata kanë për ditët e para të vitit shkollor dhe emocionet që përjetojnë.

Zhvillimi i mësimi: duke u bazuar në libër, lexoni tekstin e këngës dhe bisedoni në mënyrë të lirë me nxënës.

Para se të fillon mësimi i këngës, nxënësit e dëgjojnë incizimin e këngës, me qëllim që ta ndiejnë bukurinë dhe karakterin e këngës. Nxënësit, me ndihmën e mësuesit/es, fillojnë ta mësojnë këngën sipas veshit, në bazë të veprimeve standarde metodologjike: kënga mësohet e ndarë në strofa, dhe pastaj mësohet kënga në tërësi.

Gjithashtu, gjatë orës mund të flisni lidhur me kompozitorët tanë, të cilët dhanë kontribut në fushën e muzikës, duke na dhuruar këngë të bukura për fëmijë. Një ndër to është edhe Pranvera Badivuku, e cila është kompozitorja jonë më e njohur në fushën e këngës për fëmijë. Ajo me dashuri të madhe i është përkushtuar krijimit të këngëve për fëmijë.

Pjesa përfundimtare - nxënësit mund ta këndojnë këngën, të ndarë në grupe ose ta këndojnë me ndarje tjetër, (solisti e këndon pjesën e parë të këngës dhe pastaj refrenin ta këndojë tërë klasa).

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi formativ: nxënësi/ja në fund të orës shqipton drejt tekstin e këngës me ritëm dhe në këtë mënyrë fillon aftësia dhe ndjenja për ritëm.

Fusha kurrikulare: Artet	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e Kurrikulës: Shkalla: II	Klasa: IV
Tema nga plani dymujor: Elementet bazike të gjuhës artistike Elementet muzikore Shkrim leximi Format muzikore		RNT: Luan lojëra të thjeshta muzikore, të shoqëruara me këngë, të cilat kanë gjuhën shprehëse të përshtatshme me fjalorin e moshës së tyre, të përcjella me lëvizje trupore, e me vegla muzikore fëmijërore dhe që trajtojnë tema të ndryshme, por edhe elemente didaktike të gjuhës artistike muzikore (ritmi, melodia, vetitë e tingullit muzikor etj.). Luan lojëra të ndryshme ku sinkretizohet fjala, muzika, mimika, lëvizja, ana vizuale etj. (tematika e lojërave përshtatet me tematikat nga fushat e tjera mësimore për këtë klasë).	
RNK: I.3, II.4, III.2, III.4, III.7.			
RNF:1.6, 2.1,			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Bota e tingujve			
Fjalët kyçe: <i>tingulli i lehtë, tingulli i zëshëm, tingulli i zhurmshëm;</i>			
Rezultati i të nxënës të orës mësimore: Nxënësi: Njeh tingujt rreth vetes; Identifikon burimet e tingujve; Imiton tinguj.		Kriteret e suksesit: - Emërton së paku 5 tinguj rreth vetes; - Identifikon saktë burimet e tingujve duke u bazuar në ilustrime - Imiton saktë tingujt e krijuar nga shoku/shoqja.	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukata muzikore, kasetofoni me CD, interneti.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative.			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore:			
Pjesa hyrëse: në fillim, nxënësit do të analizojnë ilustrimet në libër. Imazhet në libër do t'u ndihmojnë atyre që të zbulojnë dhe të identifikojnë tingujt që mund të dëgjohen në ilustrimet që kanë para. Nxitni nxënësit që të gjejnë sa më shumë tinguj që dëgjojnë në rrethin ku jetojnë. Kërkoni që të imitojnë tingujt e ndryshëm që dëgjojnë në shtëpi, në rrugë, qytete, fshatra, në pallate ku jetojnë, ose në vende si xhungla, deti etj. Pastaj, tingujt mund t'i prodhojnë me zë, por edhe me instrumentet e ndërtuara, ose edhe gjësende të rëndomta.			
Zhvillimi i mësimi: pasi nxënësit të kenë identifikuar tingujt e ndryshëm, kërkoni që të			

komentojnë edhe ilustrimet në libër. Cilat janë ambientet që ata shohin në libër. Çfarë tingujsh gjejmë në ato ilustrime? Pra, detyra që u shtrohet nxënësve është që të identifikojnë burimet tingullore të ilustrimeve nga libri.

Pjesa përfundimtare: nxënësit mund të luajnë duke imituar tinguj zërash. Njëri nxënës imiton dhe prodhon tinguj, ndërsa të tjerët do ta qëllojnë burimin tingullor. Në mënyrë që loja të bëhet edhe më interesante, nxënësi/ja, me sy të mbyllur, do të dëgjojë tingujt që nxënësit e tjerë do të krijojnë dhe përpos identifikimit ai/ajo do të qëllojë edhe vendndodhjen e tingullit (nëse tingulli që prodhohet është afër, larg, majtas, djathtas etj.).

Vlerësimi i nxënësve: nxënësi/ja në fund të orës vëren dhe është më i/e vëmendshëm/me rreth botës tingullore.

Fusha kurrikulare: Artet	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e Kurrikulës: Shkalla: II	Klasa: IV
Tema nga plani dymujor: Elementet bazike të gjuhës artistike Elementet muzikore Shkrim leximi Format muzikore		RNT: Dallon elementet themelore muzikore (ritmi, melodia dhe harmonia (dur-mol) ne këngët, lojërat dhe veprat muzikore që ata i këndojnë në klasë dhe në të tjera vepra muzikore që dëgjojnë. Njeh dhe përdor notacionin muzikor bazik për (gjatësitë dhe lartësitë tingëllore (7 tingujt muzikor) për performim dhe krijim e shprehje muzikore. Identifikon dukuritë muzikore ritmike e melodike, në këngët e kënduara dhe në veprat e dëgjuara. Perjeton dhe dallon dy dhe tre pjeshmërinë në këngët e kënduara.	
RNK: I.5,6. II.8. III.2,3 V.8.			
RNF: 1.1, 2.1, 3.2.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: solisti/ja dhe kori			
Fjalët kyçe: muzika, kënga, solisti, kori.			
Rezultati i të nxënësve të orës mësimore: Nxënësi: Njeh interpretuesit ; Identifikon llojet e institucioneve artistike; Këndon këngë në grup.		Kriteret e suksesit: Përgjigjen saktë së paku në njërin nga pyetjet e parashtruar; Interpreton së paku njërin nga rolet solist/kor duke kënduar këngët e mësuara Argumenton me shembuj konkret dallimin mes solistit dhe korit .	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukata muzikore, kasetofoni me CD.			

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, Njeriu dhe natyra, Edukatë figurative, Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm.

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Pjesa hyrëse: mësuesi/ja bashkëbisedon me nxënësit se të kënduarit siç kanë parë dhe dëgjuar, mund të bëhet nga një këngëtar i vetëm ose edhe nga shumë këngëtarë së bashku. Pyetni nëse ata kanë ndjekur koncerte më herët dhe nëse jo, inkurajoni që t'i përcjellin ato.

Ata të cilët kanë ndjekur koncertet ose kanë parë ato, kanë arritur të vërejnë se ndonjëherë këngëtarët interpretojnë vetëm në skenë, ndonjëherë me përcjellje të instrumentistëve. Ju duhet të shpjegoni se këngëtari/ja që këndon vetëm në skenë ose me përcjellje quhet solist/e, ndërsa nëse është një grup më i madh këngëtarësh në skenë, atëherë e quajmë kor.

Zhvillimi i mësimi: që nxënësit të kuptojnë më mirë, mësuesi/ja përdor shembuj muzikorë për të dalluar zërin ose vokalin e një solisti nga zërat e shumë solistëve që ndryshe njihen si kor. Pyetni nxënësit nëse kanë dëgjuar kore më herët, ku kanë dëgjuar dhe cilat janë ato?

Pjesa përfundimtare - në fund të orës, nxënësit mund të luajnë një lojë. Dikush nga ta zgjidhet solist dhe nxënësit e tjerë përbëjnë korin. Këndojnë këngët e mësuara më parë.

Lavdërohen nxënësit për realizimin e orës muzikore.

Vlerësimi i nxënësve :

Vlerësim formativ: nxënësi/ja, në fund të orës, identifikon të kënduarit e solistit dhe korit.

Fusha kurrikulare: Artet	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e Kurrikulës: Shkalla: II	Klasa: IV
Tema nga plani dymujor: Elementet bazike të gjuhës artistike Elementet muzikore Shkrim leximi Format muzikore		RNT: Dallon elementet themelore muzikore (ritmi, melodia dhe harmonia (dur-mol) ne këngët, lojërat dhe veprat muzikore që ata i këndojnë në klasë dhe në të tjera vepra muzikore që dëgjojnë. Njeh dhe përdor notacionin muzikor bazik për (gjatësitë dhe lartësitë tingëllore (7 tingujt muzikor) për performim dhe krijim e shprehje muzikore. Identifikon dukuritë muzikore ritmike e melodike, në këngët e kënduara dhe në veprat e dëgjuara. Perjeton dhe dallon dy dhe tre pjeshmërinë në këngët e kënduara Krijon melodi të thjeshta (me zë dhe instrumente muzikore) në formën 2 dhe 3 pjesore të këngës.	
RNK: I.3, 5. II.7, III.2,3,5. V.8			
RNF: 1.2, 3.4.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Didaktike : Nota SOL fq. 13 Nota MI fq. 32			
Fjalët kyçe: notat muzikore , lartësia e tyre.			
Rezultati i të nxënësve të orës mësimore: Nxënësi: Njeh notat SOL dhe MI; Identifikon notat; Këndon sipas lartësisë së notave muzikore.		Kriteret e suksesit: Vizaton saktë notat SOL dhe MI në pentagram; Emërton saktë notat e paraqitura në partiturën e këngës; Këndon me saktësi sipas lartësisë së notave muzikore.	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukata muzikore, kasetofoni me CD.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuha shqipe; Edukatë figurative; Shoqëria dhe mjedisi.			

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Pjesa hyrëse - mësuesi/ja bashkëbisedon me nxënësit lidhur me shkrimin e notave. Mësuesi/ja shpjegon se para se të shkruhen notat muzikore në pentagram, së pari shkruhet çelësi muzikor. Duke kënduar mësuesi/ja dhe duke kërkuar që të jenë më të vëmendshëm, nxënësit vërejnë notën SOL dhe notën MI.

Zhvillimi i mëimit - gjersa dëgjojnë bashkë shembullin përmes CD-së, ata do të shikojnë tekstet në libër. Në vazhdim ata mund të identifikojnë këto nota në partiturat e këngëve që kanë mësuar më parë dhe në këtë formë ata do të familjarizohen me to, duke e bërë edhe më argëtues mësimin e tyre. Ushtrimet do të bëhen përmes dëgjimit, por edhe përmes këndimit. Në këtë mënyrë, ata do të vërejnë lartësinë e notave muzikore SOL dhe MI.

Pjesa përfundimtare - kërkohet nga nxënësit të këndojnë me nota pastaj edhe me tekst, në grupe pastaj tërë klasa.

Vlerësohen dhe lavdërohen nxënësit për realizimin e orës mësimore.

Vlerësimi i nxënësve :

Vlerësim formativ: nxënësi zhvillon të kënduarit me tekst dhe me nota muzikore.

Fusha kurrikulare: Artet	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e Kurrikulës: Shkalla: II	Klasa: IV
Tema nga plani dymujor: Këngët		RNT(nga plani dymujor): Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grupe) sipas imitimit dhe nocionit simbolik (grafik). Këngët dhe meloditë e shoqërimet instrumentale trajtojnë tema të ndryshme të përshtatshme për moshën e tyre (për natyrën, shkollën, familjen, dëshirat, lodrat, stinët, festat etj.).	
RNK: I.4, 6. II. 5,6,7,8. V.8.			
RNF:1.1.5. 2.1. 4.1.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Katër stinët			
Fjalët kyçe: stinët, pranvera, vera, vjeshta, dimri.			
Rezultati i të nxënësve të orës mësimore: Nxënësi: Shqipton tekstin saktë; Zhvillon aftësinë dhe ndjenjën për ritëm; Këndon këngën me intonacion.		Kriteret e suksesit: Kriteret e suksesit: Mëson saktë vargjet e tekstit; Këndon këngën me intonacion dhe ritëm të saktë; Vizat stinën e preferuar duke u bazuar në këngën që mësuam.	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukata muzikore, Kasetofoni me CD.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Shoqëria dhe mjedisi, Njeriu dhe natyra, Edukatë figurative, Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm.			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtarisë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore:			
Pjesa hyrëse: mësuesi/ja pyet nxënësit se sa stinë i ka viti, në cilën stinë janë dhe cila u pëlqen më shumë dhe përse. Nxënësit përshkruajnë stinën e preferuar me pak fjalë. Për ta mësuar më lehtë tekstin e këngës, mësuesi/ja e shkruan në tabelë dhe pastaj fillohet me përvetësimin e tekstit e melodisë. Zhvillimi i mëimit: përmes CD-së, dëgjohet kënga, komentohet teksti i saj, pastaj kërkohet nga nxënësit që ta këndojnë strofën e parë duke shikuar në tabelë dhe duke dëgjuar melodinë e saj. Kështu vazhdohet derisa të përvetësohet kënga në tërësi, duke kënduar saktë melodinë e këngës (sipas veshit). Gjatë orës, bashkërisht mund të rikujtohet vepra e kompozitorit <i>Vivaldi</i>, e cila mban titullin “Stinët”. Pjesa përfundimtare: këndohet kënga me grupe duke vlerësuar këndimin e nxënësve dhe në fund e tërë klasa këndon së bashku. Duke dëgjuar dhe kënduar, kërkohet nga nxënësit që ta vizatojnë stinën e preferuar. Pyetni nxënësit se, në stinën e preferuar, cilat aktivitete dhe çfarë lojërave zhvillojnë.			
Vlerësimi i nxënësve :			
Vlerësim formativ: nxënësi/ja, në fund të orës, shqipton drejt tekstin e këngës dhe zhvillohet aftësia dhe ndjenja për ritëm.			

Fusha kurrikulare: Artet	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e Kurrikulës: Shkalla: II	Klasa: IV
Tema nga plani dymujor: Elementet bazike të gjuhës artistike Elementet muzikore Shkrim leximi Format muzikore		RNT: Dallon elementet themelore muzikore (ritmi, melodia dhe harmonia (dur-mol) ne këngët, lojërat dhe veprat muzikore që ata i këndojnë në klasë dhe në të tjera vepra muzikore që dëgjojnë. Njeh dhe përdor notacionin muzikor bazik për (gjatësitë dhe lartësitë tingëllore (7 tingujt muzikor) për performim dhe krijim e shprehje muzikore.	
RNK: I.3, 5. II.7, III.2,3,5. V.8			
RNF: 1.2, 3.4.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: të rikujtojmë: <i>Pentagrami, çelësi muzikor dhe notat muzikore</i> (fq. 11-12)			
Fjalët kyçe: <i>pentagrami, çelësi muzikor, notat muzikore.</i>			
Rezultati i të nxënësve të orës mësimore: Nxënësi: Njeh pentagramin; Shkruan notat muzikore; Këndon notat muzikore.		Kriteret e suksesit: Vizaton pentagramin saktë me të gjitha elementet; Paraqet notat saktë në pentagramin e vizatuar; Këndon me saktësi sipas lartësisë së notave muzikore.	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukata muzikore, kasetofoni me CD.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuha shqipe; Edukatë figurative, Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm.			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore:			

Pjesa hyrëse - mësuesi/ja shpjegon duke rikujtuar se në pentagram së pari shënohet çelësi muzikor (çelësi SOL), pastaj notat muzikore. Pentagrami përbëhet nga pesë vija horizontale dhe katër fusha. Mësuesi/ja e paraqet edhe në tabelë, duke u shpjeguar nxënësve.

Zhvillimi i mësimit - kalohet në libër për të mësuar më shumë se si janë të radhitura notat në vija dhe në fusha të pentagramit, por që varësisht prej lartësisë së tyre, mund të shkruhen edhe në/përmes vijave ndihmëse.

Pjesa përfundimtare - te pjesa përfundimtare bëhet përsëritja e mësimit për të përvetësuar njësinë.

Aktivitet:

Për realizimin e aktivitetit me butonë do të nevojitet një letër/karton, në të cilin do të vizatohet pentagrami , 5 fije peri dhe 8 pulla me ngjyra ose edhe ndonjë kokërr gruri apodiçka e ngjashme. Ngjiten fijet e perit me ngjitës, pastaj ngjiten butonët në vendet e duhura dhe të renditur bukur, që simbolizojnë notat muzikore. Shkruhen notat dhe pastaj, së bashku, vlerësohen punimet.

Vlerësimi i nxënësve :

Vlerësim formativ: nxënësi/ja zhvillon perceptimin dhe këndimin e lartësisë së notave në pentagram.

Fusha kurrikulare: Artet	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e Kurrikulës: Shkalla: II	Klasa: IV
Tema nga plani dymujor: Veprat artistike; Ngjarjet artistike		RNT: Shpreh reagimin personal e emocional ndaj përjetimit të veprës artistike me disa fjali të thjeshta, gjatë bisedës dhe vrojtimit , me lëvizje, mimikë, me mjete shprehëse të tjera artistike etj. Çmon dhe vlerëson performancën/krijimet artistike vetanake dhe të tjerëve me fjalor e terma adekuatë Krijon shprehi për dëgjim të vazhdueshëm të veprave muzikore dhe për muzikim. Përkshkruan dhe komenton (me forma të ndryshme shprehëse: me gojë, me shkrim, me shprehje figurative etj.) ndonjë ngjarje muzikore artistike të përjetuar në familje, në shkollë, në koncert, nga TV etj.	
RNK: I.3, I.4, I.5, III.1, III.4,			
RNF: 2.1, 3.2, 4.1			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Dëgjim - Edvard Grieg “Disponimi mëngjesor” (Peer Gynt)			
Fjalët kyçe: krijues, performues, instrumente muzikore, vepra artistike.			
Rezultati i të nxënës të orës mësimore: Nxënësi: Njih krijuesin muzikor; Dallon veprën artistike; Zhvillon shprehi për dëgjim muzikor. Përzgjedh instrumentin e pëlqyer		Kriteret e suksesit: -Emërton krijuesin (kompozitorin); -Përkshkruan ndonjë vepër artistike me fjali të thjeshta; -Shpreh emocionet me njërin nga format shprehëse gjatë dëgjimit muzikor. -Arsyeton me dy fjali përzgjedhjen e instrumentit	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukata muzikore, Kasetofoni me CD, interneti.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative, Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm..			
Përkshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore:			
Pjesa hyrëse: mësuesi/ja mund ta fillojë orën duke i pyetur nxënësit se sa dëgjojnë ata dhe sa i njohin autorët dhe muzikën e orkestrave të mëdha. Nxënësit do t’u sqarohet se sa e rëndësishme është muzika dhe se ajo përpos rëndësisë së vet që ka, duke na transmetuar emocion dhe një ngjarje të caktuar, ajo i jep jetë dhe e pasuron botën e filmit gjithashtu - si atyre për fëmijë, ashtu edhe për të rritur. Grieg-u është kompozitor i njohur norvegjez . Vepra e tij “Disponimi mëngjesor” është vepër në të			

cilën do të njohim tingullin e instrumenteve si oboa dhe flauti, por aty nuk do të mungojnë edhe instrumentet harkore. Përmes lojës, dëgjimit, ata do të njoftohen më afër me këto instrumente, por edhe me ritmin që ajo ka. Grafika/ilustrimi në libër do t’u ndihmojë atyre që të përcjellin veprën.

Zhvillimi i mësimi:

Nxënësit dëgjojnë me vëmendje veprën muzikore “Disponimi mëngjesor”, duke përcjellë ilustrimin në libër. Ritmi është elementi në të cilin duhet pasur kujdes, por gjithashtu kujdes të veçantë t’u kushtohet ngjyrave të instrumenteve. Përmes grafikës/ilustrimit në libër, ata përcjellin atë. Pasi ta kenë përvetësuar përcjelljen e veprës përmes ilustrimit, bashkë mund të dëgjojnë edhe variantet e tjera të kësaj vepre.

Pjesa përfundimtare: pyetni nxënësit se cili instrument është i preferuari i tyre.

Vlerësimi i nxënësve: nxënësi/ja në fund të orës njihet me rolin e krijuesit (kompozitorit, rolin e dirigjentit dhe të instrumentistëve), krijimet, dinamikën, ngjyrimin dhe tingujt në veprën muzikore. Nxënësi do të fillojë të njohë literaturën e muzikës klasike.

Fusha kurrikulare: Artet	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e Kurrikulës: Shkalla: II	Klasa: IV
Tema nga plani dymujor: Lojërat muzikore		RNT: Luan lojëra të thjeshta muzikore, të shoqëruara me këngë, të cilat e kanë gjuhën shprehëse të përshtatshme me fjalorin e moshës së tyre, të përcjella me lëvizje trupore e me vegla muzikore fëmijërore dhe që trajtojnë tema të ndryshme, por edhe elemente didaktike të gjuhës artistike muzikore (ritmi, melodia, vetitë e tingullit muzikor etj.). Luan lojëra të ndryshme ku sinkretizohet fjala, muzika, mimika, lëvizja, ana vizuale etj. (tematika e lojërave përshtatet me tematikat nga fushat e tjera mësimore për këtë klasë).	
RNK: I.5,6. II.8. III.2,3 V.8.			
RNF: 1.1, 2.1, 3.2.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Forma Muzikore/Notat muzikore, melodia dhe ritmi			
Fjalët kyçe: notat muzikore , lartësia e tyre, melodia.			

Rezultati i të nxënësve të orës mësimore: Nxënësi: -Njihet notat muzikore; -Zhvillon aftësinë e këndimit; -Këndon notat muzikore.	Kriteret e suksesit: -Emërton saktë notat muzikore; -Këndon me melodi sipas lartësisë notat; -Ndjek ritmin e notave me saktësi.
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukata muzikore, kasetofoni me CD, ksilofoni.	
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuha shqipe; Edukatë figurative, Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.	
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtarisë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore:	
Pjesa hyrëse - mësuesi/ja bashkëbisedon me nxënësit për të përsëritur se si para se të shkruhen notat muzikore, gjithsesi së pari shkruhet çelësi muzikor. Duke u bazuar në libër, nxënësve duhet t'u sqarohet se çfarë gjatësie kanë ato. Duke dëgjuar CD-në, ose duke luajtur në ksilofon, nxënësit dëgjojnë me vëmendje për të vërejtur melodinë dhe gjatësinë e notave. Në vazhdim do të flisni edhe për formën muzikore. Në muzikë ka këngë dy dhe tri- pjesore, dhe ndryshe ato quhen edhe A (pjesa e parë), B (pjesa e dytë). Në rast se pjesa e parë A përsëritet, atëherë do ta kemi këngën tripjesore ABA. Zhvillimi i mësimi: kalohet në libër duke sqaruar dhe komentuar notat muzikore dhe gjatësinë e tyre. Për të pasur më të qartë, nxënësit shkruajnë notat te grafiku i notave që të këndohet më lehtë. Fillohet me këndimin e notave së bashku, duke përsëritur disa herë. Ndërsa për ta kuptuar formën muzikore më lehtë, gjatë orës mund të zhvillohet një lojë. Përmes dëgjimit, nxënësit do ta vërejnë melodinë e pjesës së parë (A), dhe do të sillen bashkë në rreth. Në momentin që dëgjojnë ndryshimin, melodinë e pjesës së dytë (B), ata ulen të gjithë. Pjesa përfundimtare - duke shikuar në libër, kërkohet nga nxënësit të këndojnë me nota, njëherë në grupe e pastaj tërë klasa. Kërkohet nga nxënësit që të krijojnë një melodi të cilën do të mundohen edhe ta këndojnë.	
Vlerësimi i nxënësve : Vlerësim formativ: nxënësi/JA zhvillon të kënduarit me nota muzikore .	

Fusha kurrikulare: Artet	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e Kurrikulës: Shkalla: II	Klasa: IV
Tema nga plani dymujor: Këngët		RNT: Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grupe) sipas imitimit dhe nocionit simbolik (grafik). Këngët dhe meloditë e shoqërimet instrumentale trajtojnë tema të ndryshme, të përshtatshme për moshën e tyre (për natyrën, shkollën, familjen, dëshirat, lodrat, stinët, festat etj.). Shoqëron këndimin me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë sipas instruksioneve të mësimeve dhe në mënyrë kreative.	
RNK: I.4, 6. II. 5,6,7,8. V.8.			
RNF:1.1.5. 2.1. 4.1.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Kënga “Prilli piktor”			
Fjalët kyçe: viti, stinët, muajt.			
Rezultati i të nxënësve të orës mësimore: Nxënësi: Dëgjon me vëmendje këngën; Mëson tekstin e këngës; Këndon këngën; Vizat një peizazh.		Kriteret e suksesit: Komenton tekstin me së paku me dy fjali pas dëgjimit të këngës; Këndon këngën me ritëm ,intonacion e shprehje artistike. Vizat bukur peizazhin i cili përkon me stinën	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukata muzikore, kasetofoni me CD.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Shoqëria dhe mjedisi, Njeriu dhe natyra, Edukatë figurative.			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore:			

Pjesa hyrëse: ora mund të fillojë me një diskutim lidhur me stinët. Bashkë do të shohim nëse nxënësit njohin stinët dhe diferencën në mes tyre. Mësuesi/ja pyet nxënësit se në cilën stinë janë, sa stinë ka viti, në cilën stinë është muaji prill, çfarë ndodh me natyrën në këtë muaj etj. Gjithashtu, pyetni nxënësit se, në muajin prill, cilat aktivitete dhe çfarë lojërash zhvillojnë.

Zhvillimi i mësim: përmes CD-së, dëgjohet kënga, komentohet teksti i saj, pastaj kërkohet nga nxënësit që ta këndojnë strofën e parë, duke shikuar tekstin në dërrasë të zezë dhe duke dëgjuar melodinë e saj. Kështu vazhdohet derisa të përvetësohet kënga në tërësi, duke kënduar saktë melodinë e këngës (sipas veshit).

Pjesa përfundimtare: këndohet kënga me grupe duke vlerësuar këndimin e nxënësve dhe në fund e tërë klasa këndon së bashku.

Duke dëgjuar dhe kënduar, kërkohet nga nxënësit që ta vizatojnë një peizazh i cili përkon me stinën.

Vlerësimi i nxënësve :

Vlerësim formativ: nxënësi/ja, në fund të orës, shqipton drejt tekstin e këngës dhe zhvillohen aftësia e ndjenja për ritëm.

Fusha kurrikulare: Artet	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e Kurrikulës: Shkalla: II	Klasa: IV
Tema nga plani dymujor: Veprat artistike;		RNT: Shpreh reagimin personal e emocional ndaj përjetimit të veprës artistike me disa fjali të thjeshta gjatë bisedës dhe vrojtimit, me lëvizje, mimikë, me mjete shprehëse të tjera artistike etj. Çmon dhe vlerëson performancën/krijimet artistike vetanake dhe të tjerëve, me fjalor e terma adekuatë. Krijon shprehi për dëgjim të vazhdueshëm të veprave muzikore dhe për muzikim. Përshkruan dhe komenton (me forma të ndryshme shprehëse, si: me gojë, me shkrim, me shprehje figurative, etj.) ndonjë ngjarje muzikore artistike të përjetuar në familje, në shkollë, në koncert, nga TV etj.	
RNK: I.3, I.4, I.5, III.1, III.4,			
RNF: 2.1, 3.2, 4.1			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Piktura dhe muzika			

Fjalët kyçe: krijuesi, performuesi, vepra artistike.

Rezultati i të nxënit të orës mësimore:

Nxënësi:

Njeh krijuesin dhe performuesin;

Dallon rolet e tyre;

Shpreh emocione gjatë dëgjimit muzikor dhe shikimit të veprave artistike.

Kriteret e suksesit:

Emërton disa profesione të muzikës;

Identifikon disa dallime të krijuesit nga performuesi dhe anasjelltas;

Paraqet me fjali të thjeshta emocionet e veta pas dëgjimit të muzikës dhe shikimit të veprave artistike.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukata muzikore, kasetofoni me CD, interneti.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore:

Pjesa hyrëse: bashkë me nxënësit, diskutoni lidhur me fushat e ndryshme të artit dhe lidhjen në mes tyre. Inkurajoni ata që të vizitojnë galerinë e qytetit, të përcjellin koncerte, të vizitojnë muzetë etj. Gjatë orës, mund të bisedoni lidhur me lidhjen në mes arteve dhe se si artistët figurativë shpeshherë frymëzimin e kanë gjetur te kompozitorët, por edhe anasjelltas. Kompozitorët shpeshherë kanë gjetur frymëzim nga pikturat e artistëve siç është rasti, ta zëmë, i kompozitorit rus *Modest Mussorgsky*, i cili gjen frymëzim nga *Viktor Hartmann*-i. Por, edhe *Kandinsky* është frymëzuar nga stili i veçantë i kompozitorit austriak *Arnold Schoenberg*.

Zhvillimi i mësimi: kaloni në libër për të komentuar fotot e dhëna dhe për të kuptuar lidhshmërinë e krijuesve të mëdhenj botërorë, në mes atyre të artit figurativ dhe artit muzikor. Pra siç shihet, krijuesit e mëdhenj janë frymëzuar nga njëri-tjetri. Dëgjoni veprën e kompozitorit Mussorsky *“Pikturat në një ekspozitë”* - vepër e frymëzuar nga piktori *Viktor Hartmann*, që ta kuptojnë më mire emocionin që ajo bart. Pastaj, duke dëgjuar ndonjë vepër, ata mund të pikturojnë vetë dhe të shfaqin emocionin e tyre përmes lapsit.

Pjesa përfundimtare: kontrolloni vizatimet, duke pyetur se çfarë kanë paraqitur dhe si janë inspiruar.

Vlerësoni punimet dhe lavdëroni nxënësit për realizimin e orës muzikore.

Vlerësimi i nxënësve: nxënësi/ja në fund të orës mëson për krijuesin, performuesin dhe veprat artistike.

Fusha kurrikulare: Artet	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e Kurrikulës: Shkalla: II	Klasa: IV
Tema nga plani dymujor: Lojërat muzikore		RNT: Luan lojëra të thjeshta muzikore e të shoqëruara me këngë të cilat e kanë gjuhën shprehëse të përshtatshme me fjalorin e moshës së tyre, të përcjella me lëvizje trupore e me vegla muzikore fëmijërore dhe që trajtojnë tema të ndryshme, por edhe elemente didaktike të gjuhës artistike muzikore (ritmi, melodia, vetitë e tingullit muzikor etj.). Luan lojëra të ndryshme ku sinkretizohet fjala, muzika, mimika, lëvizja, ana vizuale etj. (tematika e lojërave përshtatet me tematikat nga fushat e tjera mësimore për këtë klasë).	
RNK: I.4, 6. II. 5,6,7,8. V.8.			
RNF:1.1.5. 2.1. 4.1.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Masa 2/4 & Ligjërime ritmik - Gëzim vjeshte			
Fjalët kyçe: notat tetëshe, gjatësia dhe lartësia e tyre.			
Rezultati i të nxënësve të orës mësimore: Nxënësi: Njeh notat tetëshe; Emërton notat tetëshe; Zhvillon aftësinë dhe ndjenjën për ritëm.		Kriteret e suksesit: Dallon notat tetëshe; Këndon gjatësinë e tyre; Këndon me ritëm.	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukata muzikore, kasetofoni me CD.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Shoqëria dhe mjedisi, Njeriu dhe natyra, Edukatë figurative, Gjuha shqipe, Matematikë, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore:			
Pjesa hyrëse: mësuesi/ja bashkëbisedon me nxënësit për stinën e vjeshtës dhe bukurinë e saj. Gjithashtu, ua përkujton nxënësit se sa të rëndësishme janë vlerat e notave dhe gjatësia e tyre. Bashkë do të mësojnë për notat tetëshe dhe për gjatësinë e tyre. Do të mësojnë se si tingëllojnë ato në shembullin e vjeshtës, por në të njëjtën kohë të njihen vizualisht duke mësuar edhe se si shkruhen ato. Mësuesja paraqet grafikun e notës tetëshe në pentagram, duke kërkuar të njëjtën detyrë edhe nga nxënësit. Në libër mund të shohin gjëegjëzën dhe do ta shohin se disa rrokje ndonjëherë theksohen më shumë, ndërsa ndonjë më pak. Mësuesi/ja u tregon nxënësve se nëse i bëjmë bashkë një rrokje të theksuar e një të patheksuar, fitojmë një MASË. Masat shënohen me një vijë vertikale. Masa e përbërë prej një pjese të theksuar dhe prej një pjese të patheksuar quhet masë dypjesore .			

Zhvillimi i mësim: hapen librat për të parë notat tetëshe se si duken. Mësuesi/ja këndon ligjërimin ritmik, dhe pastaj të njëjtën e kërkon nga e tërë klasa.

Pjesa përfundimtare: ligjërimi këndohet, në grupe dhe individualisht. Lavdërohen nxënësit për realizimin e orës muzikore.

Aktivitet: Ushtrime - Masa 2/4

Vlerësimi i nxënësve :

Vlerësim formativ: nxënësi/ja, në fund të orës, zhvillon aftësinë dhe ndjenjën për ritëm.

Fusha kurrikulare: Artet	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e Kurrikulës: Shkalla: II	Klasa: IV
Tema nga plani dymujor: Këngët		RNT (nga plani dymujor): Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grupe) sipas imitimit dhe nocionit simbolik (grafik). Këngët dhe meloditë e shoqërimet instrumentale trajtojnë tema të ndryshme, të përshtatshme për moshën e tyre (për natyrën, shkollën, familjen, dëshirat, lodrat, stinët, festat etj.). Shoqëron këndimin me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë, sipas instruksioneve të mësimdhënësit dhe në mënyrë kreative.	
RNK: I.4, 6. II. 5,6,7,8. V.8.			
RNF:1.1.5. 2.1. 4.1.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Kënga “Fëmijët e Kosovës”			
Fjalët kyçe: fëmijët, Kosova, paqe, Evropa.			
Rezultati i të nxënësve të orës mësimore: Nxënësi: Dëgjon me vëmendje këngën; Mëson tekstin e këngës; Këndon këngën; Vizat flamurin.		Kriteret e suksesit: Komenton tekstin me së paku me dy fjali pas dëgjimit të këngës; Këndon këngën me ritëm ,intonacion e shprehje artistike. Vizat bukur flamurin e Kosovës	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukata muzikore, kasetofoni me CD.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Shoqëria dhe mjedisi, Njeriu dhe natyra, Edukatë figurative, Gjuha shqipe.			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore:			
Pjesa hyrëse: mësuesi/ja bashkëbisedon me nxënësit për shtetin tonë, Kosovën. Mësuesi/ja do			

t'i pyes nxënësit që të përshkruajnë Kosovën për bukuritë natyrore, për pamjet e qyteteve e fshatrave etj.

Zhvillimi i mësimit: përmes CD-së, dëgjohet kënga, komentohet teksti i saj, dhe pastaj kërkohet nga nxënësit që ta këndojnë strofën e parë, duke shikuar në dërrasë të zezë dhe duke dëgjuar melodinë e saj. Kështu vazhdohet derisa të përvetësohet kënga në tërësi, duke kënduar saktë melodinë e këngës (sipas veshit).

Pjesa përfundimtare: këndohet kënga me grupe, duke vlerësuar këndimin e nxënësve, dhe, në fund, e tërë klasa këndon së bashku.

Duke dëgjuar dhe kënduar, kërkohet nga nxënësit që ta vizatojnë flamurin e Kosovës.

Pyetni nxënësit se si e festojnë Ditën e Pavarësisë së Kosovës dhe çfarë aktivitete zhvillojnë në shkollë dhe në shtëpi.

Vlerësimi i nxënësve :

Vlerësim formativ: nxënësi/ja, në fund të orës, shqipton drejt tekstin e këngës dhe zhvillon aftësinë dhe ndjenjën për ritëm.

Fusha kurrikulare: Artet	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e Kurrikulës: Shkalla: II	Klasa: IV
Tema nga plani dymujor: Lojërat muzikore		RNT: Luan lojëra të thjeshta muzikore, të shoqëruara me këngë të cilat e kanë gjuhën shprehëse të përshtatshme me fjalorin e moshës së tyre, të përcjella me lëvizje trupore e me vegla muzikore fëmijërore dhe që trajtojnë tema të ndryshme, por edhe elemente didaktike të gjuhës artistike muzikore (ritmi, melodia, vetitë e tingullit muzikor etj.). Luan lojëra të ndryshme ku sinkretizohet fjala, muzika, mimika, lëvizja, ana vizuale etj. (tematika e lojërave përshtatet me tematikat nga fushat e tjera mësimore për këtë klasë).	
RNK: I.5,6. II.8. III.2,3 V.8.			
RNF: 1.1, 2.1, 3.2.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Vlerat e notave: Nota katërshe, nota tetëshe			
Fjalët kyçe: notat , vlera , gjatësia e tyre.			
Rezultati i të nxënësve të orës mësimore: Nxënësi: Njeh grafikun e notave; Identifikon notat; Këndon ushtrimin ritmik .		Kriteret e suksesit: Dallon grafikun e notave katërshe,tetëshe,gjysmë apo e plotë; Identifikon notat duke i emërtuar ato; Këndon saktë me ritëm që përcillet me shkopinj, instrumente ose laps.	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukata muzikore, kasetofoni me CD.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Matematikë; Edukatë figurative, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore:			
Pjesa hyrëse: mësuesi/ja u shpjegon nxënësve se në muzikë, në meloditë e këngëve ose në veprat muzikore që ata kanë dëgjuar, ka nota të ndryshme muzikore. Ato janë të ndryshme për nga gjatësia. Ka tinguj të shkurtër dhe të gjatë. Në këtë njësi mësimore do të shohin gjatësinë e notave katërshe, tetëshe, gjysmë dhe të plota . Nota katërshe shënohet duke e vizatuar së pari kokën e saj, e pastaj edhe qafën e saj dhe këtë do ta shohin në libër se si duket, përderisa tingujt e shkurtër do t'i quajmë nota tetëshe. Shënohen si notat katërshe, vetëm se u shtohet një flamur sipër. Një notë katërshe vlen sa dy nota tetëshe. Ndërsa një notë gjysmë përbëhet nga dy nota katërshe. Gjithashtu, edhe dy nota gjysmë të bashkuara e përbëjnë një notë me vlerë tjetër që e quajmë notë të plotë. Ka pushime me vlerë të notës gjysmë dhe me vlerë të notës së plotë.			

Zhvillimi i mësimit: që nxënësit të kuptojnë më mirë, mësuesi/ja përdor CD-në. Hapin librat duke shpjeguar saktësisht secilën notë dhe çfarë i dallon nga njëra-tjetra edhe në dukje. Paraqitet ndryshimi i tyre në tabelë, duke i emërtuar dhe po e njëjta gjë kërkohet edhe nga nxënësit. Ushtrimi ritmik mund të përcillet edhe me shkopinj, instrumente ose laps.

Ushtrohet deri sa ta kenë kuptuar diferencën mes tyre.

Pjesa përfundimtare: pasi të është ushtruar nga të gjithë nxënësit, mundeni edhe në grupe ose edhe me individë ta luani lojën ritmike.

Lavdërohen nxënësit për realizimin e orës muzikore.

Vlerësimi i nxënësve: Vlerësim formativ: nxënësi/ja, në fund të orës, identifikon notat katërshe dhe tetëshe.

Fusha kurrikulare: Artet	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e Kurrikulës: Shkalla: II	Klasa: IV
Tema nga plani dymujor: Veprat artistike; Ngjarjet artistike		RNT: Shpreh reagimin personal e emocional ndaj përjetimit të veprës artistike me disa fjali të thjeshta gjate bisedës dhe vrojtimit , me lëvizje, mimikë, me mjete shprehëse të tjera artistike etj. Çmon dhe vlerëson performancën/krijimet artistike vetanake dhe të tjerëve me fjalor e terma adekuatë. Krijon shprehi për dëgjim të vazhdueshëm të veprave muzikore dhe për muzikim. Përshkruan dhe komenton (me forma të ndryshme shprehëse: me gojë, me shkrim, me shprehje figurative, etj.) ndonjë ngjarje muzikore artistike të përjetuar në familje, në shkollë, koncert, nga TV etj.	
RNK: I.3, I.4, I.5, III.1, III.4,			
RNF: 2.1, 3.2, 4.1			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Flauti - të dëgjojmë: <i>Camille Saint-Saëns “Aviary”</i> (nga Karnavali i kafshëve)			
Fjalët kyçe: <i>flauti, instrumente muzikore, vepra artistike.</i>			
Rezultati i të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: Njeh istrumentet muzikore; Dallon muzikën klasike; Shpreh emocione gjatë dëgjimit muzikor.		Kriteret e suksesit: Emërton disa nga instrumentet muzikore; Dallon instrumentet përmes tingujve; Zhvillon shprehi për dëgjim muzikor.	

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukata muzikore, kasetofoni me CD, interneti.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative, Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm.

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Pjesa hyrëse: pyetni nxënësit nëse u kujtohen veprat që i kanë dëgjuar në klasat e mëparshme dhe nëse u kujtohen instrumentet e mësuara? Cili është instrumenti që ata preferojnë dhe nëse ata luajnë në ndonjë prej instrumenteve. Gjithashtu, gjatë mësimi mund të flitet për zogjtë që ata njohin dhe për vendin se ku ata jetojnë. Nxënësve mund t'u shpjegohet se, shumë kompozitorë, frymëzimin e kanë gjetur pikërisht te zogjtë dhe cicërimat e tyre. Ndër ta njihet kompozitori francez *Olivier Messian*. I frymëzuar nga cicërimat e zogjeve të ndryshëm, ai shkroi një mori veprash, ndër to edhe veprën e tij për piano "Katalogu i zogjeve".

Zhvillimi i mësimi: nxënësit dëgjojnë me vëmendje veprën muzikore "Shtëpia e zogjeve". Në klasat e mëparshme ata kanë dëgjuar "Karnavalin e Kafshëve", nga autori *Camille Saint Saëns*. Ta zëmë, ata kanë dëgjuar "Akuariumin" ose "Mjellmën" - pjesën për violonçel. Këtë herë ata do të mësojnë për flautin, i cili është instrument i dashur për të gjithë. Nxënësve u shpjegohet që flauti është instrument frymor që kryesisht haset në muzikën klasike, dhe se atë e gjejmë si instrument solistik, por edhe si pjesë të orkestrës.

Pjesa përfundimtare: pyetni nxënësit se a u pëlqeu kjo vepër dhe cili do të ishte një instrument tjetër i cili do të mund ta zëvendësonte flautin. Cili instrument mund t'i afrohej tingullit të zogjeve përpos flautit.

Vlerësimi i nxënësve: nxënësi/ja në fund të orës njihet me dinamikën (shpejtësinë) e muzikës klasike. Nxënësi do të fillojë të njohë literaturën e muzikës klasike.

Fusha kurrikulare: Artet	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e Kurrikulës: Shkalla: II	Klasa: IV
Tema nga plani dymujor: Elementet bazike të gjuhës artistike Elementet muzikore Shkrim leximi Format muzikore		RNT: Dallon elementet themelore muzikore (ritmi, melodia dhe harmonia (dur-mol) ne këngët, lojërat dhe veprat muzikore që ata i këndojnë në klasë dhe në të tjera vepra muzikore që dëgjojnë. Njeh dhe përdor notacionin muzikor bazik për (gjatësitë dhe lartësitë tingëllore (7 tingujt muzikor) për performim dhe krijim e shprehje muzikore. Perjeton dhe dallon dy dhe tre pjeshmërinë në këngët e kënduara	
RNK: I.3, 5. II.7, III.2,4,5. V.8			
RNF: 1.2. 3.1. 4.1.2.			

Aspektet specifike të planit të orës mësimore	
Njësia mësimore: Masa $\frac{3}{4}$ & Notat dhe pushimet	
Fjalët kyçe: <i>masa, nota, pushimet.</i>	
Rezultati i të nxënësve të orës mësimore: Nxënësi: Njeh taktimin; Luan taktimin; Njeh pushimin katërsht.	Kriteret e suksesit: Emërton fjalën taktim; Demonstron taktimin; Identifikon pushimin katërsht.
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukata muzikore, kasetofoni me CD.	
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Art figurativ; Gjuhë shqipe.	
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore:	
Pjesa hyrëse: mësuesi/ja u rikujton nxënësit se çka quajmë masë dy dhe tripjesore. Pra, nëse i bëjmë bashkë një rrokje të theksuar e një të patheksuar, fitojmë një MASË. Masat shënohen me një vijë vertikale, Masa e përbërë prej një pjese të theksuar dhe prej një pjese të patheksuar quhet masë dypjesore. Derisa masën $\frac{2}{4}$ e përbënin një rrokje e theksuar dhe një e patheksuar, masën $\frac{3}{4}$ e përbëjnë një rrokje e theksuar dhe dy të patheksuara. Këndimi mund të shoqërohet edhe me lëvizje të dorës. Nëse masa është dypjesore $\frac{2}{4}$, do ta taktojmë “një dy”. Ndërsa, nëse masa është tripjesore, atëherë do ta taktojmë “një, dy, tre” duke e shikuar ilustrimin në libër.	
Zhvillimi i mësimi: kalohet në libër, duke u bazuar në udhëzimet e tij, lëvizjet e masës $\frac{3}{4}$ dhe $\frac{2}{4}$. Filloni të ushtroni me masat e dhëna, duke u bazuar në tekstin e dhënë. Dëgjohet ndonjë këngë ritmike që bën të kuptohet më mirë takti dy dhe tripjesor. Duke luajtur dhe përvetësuar, shënohen edhe notat dhe pushimet në faqen e radhës.	
Pjesa përfundimtare: që të jetë edhe më e qartë për nxënësit, si shembuj mund të merrni edhe këngët ose ligjërimet ritmike të mësuara më parë	
Vlerësimi i nxënësve: Vlerësim formativ: nxënësi fiton njohuri për masat $\frac{3}{4}$, $\frac{2}{4}$ dhe pushimet muzikore.	

Fusha kurrikulare: Artet	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e Kurrikulës: Shkalla: II	Klasa: IV
Tema nga plani dymujor: Këngët		RNT: Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grupe) sipas imitimit dhe nocionit simbolik (grafik). Këngët dhe meloditë e shoqërimet instrumentale trajtojnë tema të ndryshme, të përshtatshme për moshën e tyre (për natyrën, shkollën, familjen, dëshirat, lodrat, stinët, festat etj.). Shoqëron këndimin me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë sipas instruksioneve të mësimdhënësit dhe në mënyrë kreative.	
RNK: I.4, 6. II. 5,6,7,8. V.8.			
RNF: 1.1.5.8 2.1. 4.1.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Biçikleta			
Fjalët kyçe: fëmijët, biçikleta, fusha, kodra.			
Rezultati i të nxënës të orës mësimore: Nxënësi: Shqipton tekstin saktë; Zhvillon aftësinë dhe ndjenjën për ritëm; Këndon këngën me intonacion.		Kriteret e suksesit: Komenton tekstin me së paku me dy fjali pas dëgjimit të këngës; Këndon saktë këngën me ritëm ,intonacion e shprehje artistike.	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukata muzikore, kasetofoni me CD.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Shoqëria dhe mjedisi, Njeriu dhe natyra, Edukatë figurative, Gjuha shqipe, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore:			
Pjesa hyrëse: mësuesi/ja bashkëbisedon me nxënësit për aktivitetet që i zhvillojnë gjatë ditës. I pyet se çfarë preferojnë më shumë nga sportet, a u pëlqen të ngasin biçikletë apo të zhvillojnë ndonjë sport tjetër. Pas diskutimit me nxënësit, kalojmë në libër.			
Zhvillimi i mësimi: përmes CD-së, dëgjohet kënga, komentohet teksti i saj, pastaj kërkohet nga nxënësit që ta këndojnë strofën e parë duke shikuar në dërrasën e zezë dhe duke dëgjuar melodinë e saj. Kështu vazhdohet derisa të përvetësohet kënga në tërësi, duke kënduar saktë melodinë e këngës (sipas veshit).			
Pjesa përfundimtare: këndohet kënga me grupe duke vlerësuar këndimin e nxënësve dhe			

duke lavdëruar. Në fund, e tërë klasa këndon së bashku.

Vlerësimi i nxënësve :

Vlerësim formativ: nxënësi/ja, në fund të orës, shqipton drejt tekstin e këngës dhe zhvillohet aftësia dhe ndjenja për ritëm.

Fusha kurrikulare: Artet	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e Kurrikulës: Shkalla: II	Klasa: IV
Tema nga plani dymujor: Elementet bazike të gjuhës artistike Elementet muzikore Shkrim leximi Format muzikore		RNT: Dallon elementet themelore muzikore (ritmi, melodia dhe harmonia (dur-mol) ne këngët, lojërat dhe veprat muzikore që ata i këndojnë në klasë dhe në të tjera vepra muzikore që dëgjojnë. Njeh dhe përdor notacionin muzikor bazik për (gjatësitë dhe lartësitë tingëllore (7 tingujt muzikor) për performim dhe krijim e shprehje muzikore. Perjeton dhe dallon dy dhe tre pjeshmërinë në këngët e kënduara	
RNK: I.3, 5. II.7, III.2,4,5. V.8			
RNF: 1.2. 3.1. 4.1.2.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Taktimi Pushimi katërsh (fq. 36-37)			
Fjalët kyçe: taktimi, pushimi katërsh.			
Rezultati i të nxënësve të orës mësimore: Nxënësi: Mëson taktimin ; Luan dhe takton saktë; Identifikon pushimin katërsh.		Kriteret e suksesit: Emërton fjalën taktim; Demonstron taktimin duke luajtur; Identifikon pushimin katërsh në melodinë e këngës.	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukata muzikore, kasetofoni me CD.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Shoqëria dhe mjedisi; Njeriu dhe natyra, Edukatë fizike ,sportet dhe shëndeti,Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore:			

Pjesa hyrëse - mësuesi/ja u sqaron nxënësve se gjatë interpretimit të ndonjë kënge ose vepre muzikore, përdoret masa e cila shënohet në fillim të fjalisë. Këndimi mund të shoqërohet edhe me lëvizje të dorës. Nëse masa është dypjesore 2/4, do ta taktojmë “një dy”, ndërsa masa është $\frac{3}{4}$ atëherë atë do ta taktojmë “një, dy, tre”. Me ndihmën e ilustrimeve në libër kjo do të vërehet më lehtë. Gjatë njësive të kaluara kemi vërejtur se kemi nota të gjata dhe të shkurtra. Pra, notat gjysmë, katërshe, tetëshe etj. Po ashtu, pushimet mund t’i kemi të tilla. Pushimi katërsh është i barabartë me notën katërshe. Në momentin që pushimi katërsh figuron, nënkuptohet se në atë vend do të pushojmë.

Se si duket shenja e pushimit katërsh, shikoni në libër.

Zhvillimi i mësimit: dëgjoni ndonjë nga këngët e mësuara më parë dhe identifikoni pushimet në melodi. Në të njëjtën kohë, këngët mund t’i taktoni me lëvizje të dorës, varësisht prej masës.

Pjesa përfundimtare: përmbledhja e punës dhe diskutim mbi taktimin e pushimin katërsh. Vlerësohen dhe lavdërohen nxënësit për realizimin e orës mësimore.

Vlerësimi i nxënësve: Vlerësim formativ: nxënësi fiton njohuri të elementeve muzikore.

Fusha kurrikulare: Artet	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e Kurrikulës: Shkalla: II	Klasa: IV
Tema nga plani dymujor: Krijimet muzikore		RNT: Improvizon në ritme të ndryshme me zë dhe instrumente ritmike. Ritmizon në mënyrë kreative vargjet, poezitë, gjëgjëzat etj. Realizon plotësimet muzikore (përfundimin e një melodie, pyetje-përgjigje muzikore etj.). Këndon ose luan në instrumente fëmijërore të shkurtër (ritmik, melodik) me inkurajimin dhe ndihmën e mësimeve .	
RNK: I.3, I.4, I.5, III.1, III.4,			
RNF: 2.1, 3.2, 4.1			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Të luajmë & të dëgjojmë: Antonio Vivaldi “Stinët”. Krijimet muzikore			
Fjalët kyçe: muzika, dëgjimi, pikturimi .			
Rezultati i të nxënësve të orës mësimore: Nxënësi: Njeh instrumentet harkore; Dallon muzikën klasike; Shpreh emocione gjatë dëgjimit muzikor; Plotëson ilustrimet ; Dëgjon veprën muzikore.		Kriteret e suksesit: Emërton disa nga instrumentet muzikore me tela; Dallon instrumentet përmes tingujve të muzikës klasike ; Plotëson saktë ilustrimet në tekst në bazë të udhëzimeve Komenton me dy fjali veprën muzikore pas dëgjimit.	

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukata muzikore, kasetofoni me CD, interneti.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Pjesa hyrëse: mësuesi/ja mund të fillojë orën duke i pyetur nxënësit se cila është stina e tyre e preferuar. Çka e dallon stinën e vjeshtës nga dimri, vera, pranvera. Gjatë orës mund të përmendet se kompozitori Antonio Vivaldi, përpos që ishte kompozitor, ai ishte edhe violinist virtuoz dhe se ai ka shkruar shumë vepra të njohura, ndër to edhe “4 Stinët” e cila është një ndër veprat më të njohura të muzikës klasike. Përmes lojës dhe dëgjimit, ata do të njoftohen më afër me këto instrumente, por edhe me ritmin që ajo ka.

Zhvillimi i mësimi: ilustrimi në libër do t’i ndihmojë ata që të përcjellin veprën. Varësisht ritmit në vepër, ata do të ngjyrosin dhe do të plotësojnë ilustrimin. Duhet pasur kujdes në ritëm.

Pjesa përfundimtare: komentoni si e kanë përjetuar dëgjimin e veprës artistike të Antonio Vivaldit “Stinët”. Vlerësoni punimet duke iu dhënë mundësinë nxënësve që të shprehin emocionet gjatë aktivitetit që bëjnë.

Lavdërohen nxënësit për punën e bërë dhe për realizimin e orës mësimore.

Vlerësimi i nxënësve: nxënësi/ja në fund të orës njihet me instrumentet harkore me ngjyrat specifike dhe karakteret e tyre. Nxënësi do të fillojë të njohë literaturën e muzikës klasike dhe të njohë lidhjen e arteve mes tyre.

Fusha kurrikulare: Artet	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e Kurrikulës: Shkalla: II	Klasa: IV
Llojet e muzikës		RNT: Dallon lloje të ndryshme të muzikës në shoqëri përmes dëgjimit muzikor (p.sh muzikë për vallëzim, muzikë për film (vizatimor), muzikë për fëmijë, muzikë për raste të ndryshme, muzikë festive etj.). Identifikon muzikën e përshtatshme për ngjarjet dhe situatat e ndryshme. Përzgjedh muzikën e përshtatshme për ngjarjet dhe situatat e ndryshme, shfaqjet në klasë, shkollë, komunitet etj.	
RNK: I.3, II.6, III.2,4, V.8.			
RNF: 1.1,5. 2.1, 3.2,4 .			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Muzika jonë popullore - “Pranvera filloi me ardhë”			

Fjalët kyçe:	
Rezultati i të nxënësve të orës mësimore: Nxënësi: Njeh këngët popullore; Dallon meloditë muzikore; Këndon këngën.	Kriteret e suksesit: Emërton së paku tri këngë popullore; Identifikon instrumentet popullore në këngën që dëgjon; Këndon këngën solo apo në grup
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukata muzikore, kasetofoni me CD, interneti.	
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative, Njeriu dhe natyra.	
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore:	
Pjesa hyrëse: në fillim të orës, bashkë me nxënësit, do të bisedohet lidhur me instrumentet popullore që ata njohin dhe pëlqejnë. Cilat janë ato? Gjithashtu, nxënësit do të pyeten për këngët popullore që ata dinë, ku i kanë dëgjuar etj. Zhvillimi i mësim: mësuesi/ja do t’u shpjegojë nxënësve se muzika popullore është e pasur në llojlloshmërinë e saj dhe se ajo krijohet nga vetë populli. Kënga popullore “Pranvera filloi me ardhë” është këngë popullore nga Shkodra. Në Kosovë, Nexhmije Pagarusha është një nga emrat më të rëndësishëm dhe më të dashur të muzikës popullore.. Ajo ndryshe njihet edhe si “Bilbili i Kosovës”. Bashkë, do të dëgjoni këngën	

“Baresha”, të kënduar nga ajo.

Gjithashtu, do të veçohet Shaqir Hoti, i cili përpos që është flautisti i parë i diplomuar në Kosovë, ai ishte një ndër krijuesit më të mëdhenj të instrumenteve popullore. Ai ka gdhendur mbi 2000 instrumente, të cilat i ka punuar nga: dheu, gjethi, druri, kallami, briri, guri, bari, lëkura, gëzhoja e drurit frutor të arrës e të lajthisë etj.

Në pjesën e dytë të orës, do të diskutohet edhe për veshjet kombëtare.

Pjesa përfundimtare: nxënësit këndojnë në grupe dhe në fund disa herë e tërë klasa, derisa të përvetësohet kënga.

Vlerësohen dhe lavdërohen nxënësit për realizimin e orës mësimore.

Këshillë mësuesit:

Pyetni nxënësit nëse e dëgjojnë muzikën popullore dhe kërkoni nga ata të thonë disa emra të këngëtarëve që këndojnë këngë popullore dhe që ata njohin.

Vlerësimi i nxënësve: nxënësi/ja në fund të orës njihet me dinamikën dhe tingujt e muzikës popullore

Fusha kurrikulare: Artet	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e Kurrikulës: Shkalla: II	Klasa: IV
Tema nga plani dymujor: Këngët		RNT (nga plani dymujor): Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grupe) sipas imitimit dhe nocionit simbolik (grafik). Këngët dhe meloditë e shoqërimet instrumentale trajtojnë tema të ndryshme të përshtatshme për moshën e tyre (për natyrën, shkollën, familjen, dëshirat, lodrat, stinët, festat etj.). Shoqëron këndimin me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë, sipas instruksioneve të mësimdhënësit dhe në mënyrë kreative.	
RNK: I.4, 6. II. 5,6,7,8. V.8.			
RNF: 1.1.5.8 2.1. 4.1.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: <i>Vit i Ri</i>			
Fjalët kyçe: <i>Viti i Ri, dëshirat, bredhi, dhuratat.</i>			

Rezultati i të nxënësve të orës mësimore: Nxënësi: Dëgjon me vëmendje këngën; Mëson tekstin e këngës; Këndon këngën;	Kriteret e suksesit: Komenton tekstin me së paku me dy fjali pas dëgjimit të këngës; Memorizon saktë tekstin; Këndon saktë këngën me ritëm ,intonacion e shprehje artistike.
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materiale mësimore: Edukata muzikore, kasetofoni me CD.	
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Shoqëria dhe mjedisi, Njeriu dhe natyra, Edukatë figurative, Gjuha shqipe, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.	
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore:	
Pjesa hyrëse: mësuesi/ja bashkëbisedon me nxënësit për festat e fundvitit; se si, me kë dhe ku do t'i festojnë. Pyet se a do të zbukurojnë brendshin , çfarë dëshirash kanë etj. Më pas, kalojnë në libër. <i>Për ta mësuar më lehtë tekstin e këngës, mësuesi/ja mund ta shkruajë edhe në tabelë.</i> Zhvillimi i mësimit: përmes CD-së, dëgjohet kënga, komentohet teksti i saj, dhe pastaj kërkohet nga nxënësit që ta këndojnë strofën e parë, duke shikuar në tabelë dhe duke dëgjuar melodinë e saj. Kështu vazhdohet derisa të përvetësohet kënga në tërësi, duke kënduar saktë melodinë e këngës, në intonacion dhe me ritëm. Pjesa përfundimtare: këndohet kënga me grupe, por edhe me një nxënësi, duke vlerësuar këndimin e nxënësve dhe duke lavdëruar. Në fund, e tërë klasa këndon së bashku. Duke dëgjuar dhe kënduar këngën e mësuar, nxënësit shkruajnë një dëshirë për Vitin e Ri.	
Vlerësimi i nxënësve : Vlerësim formativ: nxënësi/ja, në fund të orës, shqipton drejt tekstin e këngës dhe zhvillohet aftësia dhe ndjenja për ritëm.	

Fusha kurrikulare: Artet	Lënda: Edukata muzikore	Shkalla e Kurrikulës: Shkalla: II	Klasa: IV
Tema nga plani dymujor: Elementet bazike të gjuhës artistike Elementet muzikore Shkrim leximi Format muzikore		RNT: Dallon elementet themelore muzikore (ritmi, melodia dhe harmonia (dur-mol) në këngët, lojërat dhe veprat muzikore që ata i këndojnë në klasë dhe në të tjera vepra muzikore që dëgjojnë. Një dhe përdor notacionin muzikor bazik për (gjatësitë dhe lartësitë tingëllore (7 tingujt muzikor) për performim dhe krijim e shprehje muzikore.	

	Identifikon dukuritë muzikore ritmike e melodike, në këngët e kënduara dhe në veprat e dëgjuara.
RNK: I.3, 5. II.7, III.2,3,5. V.8	
RNF: 1.2, 3.4.	
Aspektet specifike të planit të orës mësimore	
Njësia mësimore: Didaktike: Nota Do - Dordoleci; Elementet muzikore; Shkalla C-DUR	
Fjalët kyçe: <i>notat muzikore DO, shkalla C-DUR.</i>	
Rezultati i të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: Njeh notën DO; Njeh shkallën C-DUR; Këndon sipas lartësisë së notave muzikore.	Kriteret e suksesit: Emërton notat në pentagram; Arsyeton me fjalë shkallë C-DUR; Këndon me saktësi sipas lartësisë së notave
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukata muzikore, kasetofoni me CD.	
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Edukatë figurative, Gjuha shqipe, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.	
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore:	
Pjesa hyrëse: mësuesi/ja bashkëbisedon me nxënësit lidhur me Notën DO dhe Shkallën C-Dur. Duke kënduar mësuesi ose duke përdorur ndonjë tjetër formë dëgjimi, nxënësit vërejnë notën DO dhe lartësinë e saj. Shpjegoni nxënësve se vargu i dhënë me nota muzikore quhet shkallë dhe meqë fillon nga nota DO dhe përfundon me notën DO, quhet Do- maxhore ose shkalla C-DUR. Zhvillimi i mëimit: duke dëgjuar CD-në, kalohet në libër për të sqaruar dhe komentuar notën DO, si dhe ushtrimin didaktik „Dordoleci” i cili fillon me notën DO. Në vazhdim, të lexohen dhe komentohen tekstet e këngëve në libër, të cilat janë të përshtatshme dhe argëtuese për moshën e nxënësve. Ushtrojnë duke dëgjuar dhe duke kënduar deri sa të mësohen këngët e shkurtra. Në këtë mënyrë vërejnë lartësinë e notës muzikore DO. Pjesa përfundimtare: kërkohet nga nxënësit të këndojnë (në grupe pastaj tërë klasa) me nota, pastaj edhe me tekst. Vlerësohen dhe lavdërohen nxënësit për realizimin e orës mësimore. Komentohen: teksti “Dordoleci”, nga nxënësit, përjetimet në dimër që kanë pasur me borë, dhe „Zana e malit” si përrallë.	
Vlerësimi i nxënësve : Vlerësim formativ: nxënësi zhvillon të kënduarit me tekst dhe me nota muzikore duke njohur shkallën DO-maxhore (C-DUR).	

Fusha kurrikulare: Artet	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e Kurrikulës: Shkalla: II	Klasa :IV
Tema nga plani dymujor: Instrumentet muzikore		RNT: Dallon ngjyrën tingëllore të instrumenteve muzikore (popullore dhe klasike) përmes dëgjimit të veprave muzikore të përshtatshme për moshën e tyre. Identifikon dhe dallon instrumentet muzikore edhe vizualisht. Krijon instrumente muzikore ritmike me materiale ricikluese dhe organike (marakas me oriz, misër, dajre të vogla etj.). Identifikon ndonjë figurë markante nga krijuesit dhe performuesit artistikë botërorë dhe lokalë.	
RNK: I.6, III.2.3, VI.6.			
RNF: 1.5,7. 2.1 . 3.1,2,3 4.4.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Kitara - Veprat e autorëve kosovarë për instrumentin e kitarës - Llojet e kitarave			
Fjalët kyçe: <i>kitara klasike, elektrike, bas kitara.</i>			
Rezultati i të nxënësve të orës mësimore: Nxënësi: Njeh instrumentin muzikor; Dallon kitarat; Zhvillon shprehje për dëgjim muzikor.		Kriteret e suksesit: Emërton instrumentin me tela; Identifikon dallimet mes tyre; Shpreh emocione gjatë dëgjimit muzikor; Nderton instrumentin e kitarës me materiale ricikluese.	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukata muzikore, kasetofoni me CD, interneti.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative, Gjuhë shqipe, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore:			
Pjesa hyrëse: ora mund të fillohet duke i pyetur nxënësit nëse e njohin kitarën, ku e kanë parë dhe ku e kanë dëgjuar atë. Gjithashtu, pyetni nxënësit nëse ndonjë nga ta luan në këtë instrument. Bashkëbisedoni dhe tregoni se Kitara është njëri prej instrumenteve më të popullarizuara të ne dhe ka 6 tela. Kitarën e gjejmë në të gjitha llojet e muzikës. Disa nga kitaristët e njohur në fushën e muzikës klasike për kitarë në Kosovë dhe jashtë saj janë: Ehat Musa dhe Petrit Çeku.			
Zhvillimi i mësimi: shumë prej kompozitorëve kosovarë kanë shkruar për instrumentin e kitarës. Ata do të njoftohen me krijimtarinë e autorëve tanë, që kanë kompozuar numër të madh veprash për kitarë. Nga gjenerata e re e kompozitorëve që shkruajnë për kitarë, shquhet kompozitori Kreshnik Aliçkaj . Nxënësit dëgjojnë me vëmendje veprat muzikore të kompozitorëve tanë. Njëra është për kitarë solo, përderisa tjetra është për kitarë dhe violinë.			

Pjesa përfundimtare: pyetni nxënësit se a u pëlqyen këto vepra artistike muzikore, si e përjetuan dhe çfarë ndien gjatë të dëgjuarit. Bashkë, mund të dëgjohen disa shembuj të tjerë si ilustrim, se si tingëllon kitarra në zhanret e tjera muzikore (*jazz, blues, rock* etj)

Vlerësimi i nxënësve: nxënësi/ja në fund të orës njihet me dinamikën dhe tingujt e kitarës dhe violinës në veprën muzikore. Nxënësi do të fillojë të njohë literaturën e muzikës klasike.

Fusha kurrikulare: Artet	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e Kurrikulës: Shkalla: II	Klasa: IV
Tema nga plani dymujor: Elementet bazike të gjuhës artistike Elementet muzikore Shkrim leximi Format muzikore		RNT: Dallon elementet themelore muzikore (ritmi, melodia dhe harmonia (dur-mol) ne këngët, lojërat dhe veprat muzikore që ata i këndojnë në klasë dhe në të tjera vepra muzikore që dëgjojnë. Njeh dhe përdor notacionin muzikor bazik për (gjatësitë dhe lartësitë tingëllore (7 tingujt muzikor) për performim dhe krijim e shprehje muzikore. Identifikon dukuritë muzikore ritmike e melodike, në këngët e kënduara dhe në veprat e dëgjuara.	
RNK: I.3, 5. II.7, III.2,3,5. V.8			
RNF: 1.2, 3.4.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Didaktike: Nota LA/ Nota SI			
Fjalët kyçe: <i>notat muzikore, lartësia e tyre.</i>			
Rezultati i të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: Njeh notat LA dhe SI; Identifikon notat; Këndon sipas lartësisë së notave muzikore.		Kriteret e suksesit: Vizaton saktë notat LA dhe SI në pentagram; Emërton saktë notat; Këndon me saktësi sipas lartësisë së notave muzikore .	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukata muzikore, kasetofoni me CD.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuha shqipe; Edukatë figurative; Shoqëria dhe mjedisi, Njeriu dhe natyra, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm..			

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Pjesa hyrëse - mësuesi/ja bashkëbisedon me nxënësit se si para se të shkruhen notat muzikore; gjithsesi së pari shkruhet çelësi muzikor përderisa notën LA dhe notën SI do ta mësojnë duke përcjellë notat në libër.

Që ato të jenë edhe më të qarta, notat do të mund t'i diferencojnë dhe vërejnë përmes këndimit.

Zhvillimi i mësimi - pasi t'i kenë parë dhe dëgjuar lartësitë e notave LA dhe SI, ata tashmë mund t'i identifikojnë këto dy nota te këngët që kanë mësuar më parë.

Pjesa përfundimtare - kërkohet nga nxënësit të këndojnë me nota, pastaj edhe me tekst, në grupe e pastaj e tërë klasa.

Vlerësohen dhe lavdërohen nxënësit për realizimin e orës mësimore. Komentohet teksti „Topi im”, si dhe teksti te nota SI, që i kushtohet maces.

Vlerësimi i nxënësve :

Vlerësim formativ: nxënësi zhvillon të kënduarit me tekst dhe me nota muzikore.

Fusha kurrikulare: Artet	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e Kurrikulës: Shkalla: II	Klasa: IV
Llojet e muzikës		RNT: Dallon lloje të ndryshme të muzikës në shoqëri përmes dëgjimit muzikor (p.sh muzikë për vallëzim, muzikë për film (vizatimor), muzikë për fëmijë, muzikë për raste të ndryshme, muzikë festive etj.). Identifikon muzikën e përshtatshme për ngjarje dhe situata të ndryshme. Përzgjedh muzikën e përshtatshme për ngjarjet dhe situatat e ndryshme, shfaqjet në klasë, shkollë, komunitet etj.	
RNK: I.3, I.4, I.5, III.1, III.4,			
RNF: 2.1, 3.2, 4.1			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Lahuta - të dëgjojmë: <i>Drinor Zymberi “Epos”</i>			
Fjalët kyçe: <i>performuesi, instrumentet muzikore, lahuta, folklori.</i>			
Rezultati i të nxënësve të orës mësimore: Nxënësi: Njeh instrumentin muzikor; Dallon instrumentin me tela; Njeh fjalën krijues.		Kriteret e suksesit: Emërton lahutën; Përshkruan lahutën;	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukata muzikore, kasetofoni me CD, interneti.			

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Pjesa hyrëse: filloni orën duke pyetur nxënësit nëse kanë dëgjuar për instrumentin e lahutës, si duket ajo edhe se a kanë dëgjuar ndonjëherë tingujt e saj? Lahuta është një nga instrumentet tona popullore, krahas çiftelisë, kavallit, tupanit etj. Vazhdoni dhe përshkruani lahutën, duke treguar se është instrument popullor me një tel dhe se tingulli fitohet duke e rrëshqitur harkun, të bërë prej fijeve të kalit në tel, të cilin e gjejmë më shpesh në pjesën e Malësisë së Gjakovës dhe në Rugovë. Me të këndohen këngët tona epike. Më rrallë e gjejmë në muzikën klasike. Kompozitori i ri, Drinor Zymberaj, me sukses e ka përdorur këtë instrument në veprën e tij “EPOS”.

Zhvillimi i mësimi: pas diskutimit lidhur me njohjen e instrumentit të lahutës dhe gjithashtu kompozitorin nga Kosova, bashkë dhe me vëmendje do të dëgjohet vepra “Epos”.

Pjesa përfundimtare: pyetni nxënësit se si u duket ky bashkëdyzim në mes muzikës folklorike dhe klasike? Si mund t’i inkuadrojmë këto instrumentet tona popullore në zhanret e tjera muzikore. Kërkoni që të vizatojnë lahutën dhe të shkruajnë rreth saj.

Vlerësimi i nxënësve: nxënësi/ja në fund të orës njihet me dinamikën dhe tingujt e lahutës në veprën muzikore. Nxënësi do të njohë literaturën e muzikës klasike, të kombinuar me lahutën.

Fusha kurrikulare: Artet	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e Kurrikulës: Shkalla: II	Klasa: IV
Tema nga plani dymujor: Këngët		RNT: Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grupe) sipas imitimit dhe nocionit simbolik (grafik). Këngët dhe meloditë e shoqërimet instrumentale trajtojnë tema të ndryshme, të përshtatshme për moshën e tyre (për natyrën, shkollën, familjen, dëshirat, lodrat, stinët, festat etj.). Shoqëron këndimin me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë sipas instruksioneve të mësimdhënësit dhe në mënyrë kreative.	
RNK: I.4, 6. II. 5,6,7,8. V.8.			
RNF: 1.1.5.8 2.1. 4.1.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Vendi im (fq. 53)			

Fjalët kyçe: atdheu, mërgimi, malli.

Rezultati i të nxënësve të orës mësimore:

Nxënësi:

Dëgjon me vëmendje këngën;

Mëson tekstin e këngës;

Këndon këngën;

Shkruan për vendlindjen.

Kriteret e suksesit:

Komenton tekstin me së paku me dy fjali pas dëgjimit të këngës;

Memorizon saktë tekstin;

Këndon saktë këngën me ritëm ,intonacion e shprehje artistike.

Shkruan së paku një strofë me një dëshirë për vendlindjen e tyre

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukata muzikore, kasetofoni me CD.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Shoqëria dhe mjedisi, Njeriu dhe natyra, Edukatë figurative, Gjuha shqipe.

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore:

Pjesa hyrëse: mësuesi/ja bashkëbisedon me nxënësit për Kosovën; që është vendlindja jonë dhe që është shumë e bukur. Mund të flitet lidhur me bjeshkët, qytetet, fshatrat, natyrën dhe pasuritë natyrore që Kosova ka.

Gjithashtu, mund të flitet edhe për të afërm që jetojnë në mërgim, larg atdheut dhe mallin që ata ndiejnë për atdheun, mallin për familjet e tyre etj. Pas bisedës me nxënësit, dëgjohet kënga “Vendi im”, duke bashkëbiseduar lidhur me shkrimtarët të cilët kanë shkruar vargje - poezi kushtuar vendlindjes së tyre. *Për ta mësuar më lehtë tekstin e këngës, mësuesi/ja mund ta shkruajë edhe në dërrasë të zezë.*

Zhvillimi i mësimet: përmes CD-së, dëgjohet kënga, komentohet teksti i saj, dhe pastaj kërkohet nga nxënësit që ta këndojnë strofën e parë, duke shikuar në dërrasë të zezë ose në libër dhe duke dëgjuar melodinë e saj. Kështu vazhdohej derisa të përvetësohet kënga në tërësi, duke kënduar saktë melodinë e këngës.

Pjesa përfundimtare: këndohet kënga, me grupe ose edhe me një nxënësi si solist. Duke dëgjuar dhe kënduar këngën e mësuar, nxënësit shkruajnë një dëshirë për vendlindjen e tyre.

Vlerësimi i nxënësve :

Vlerësim formativ: nxënësi/ja, në fund të orës, shqipton drejt tekstin e këngës dhe zhvillohet aftësia dhe ndjenja për ritëm dhe dashuria për atdheun.

Fusha kurrikulare: Artet	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e Kurrikulës: Shkalla: II	Klasa: IV
Tema nga plani dymujor: Elementet bazike të gjuhës artistike Elementet muzikore Shkrim leximi Format muzikore		RNT: Dallon elementet themelore muzikore (ritmi, melodia dhe harmonia (dur-mol) ne këngët, lojërat dhe veprat muzikore që ata i këndojnë në klasë dhe në të tjera vepra muzikore që dëgjojnë. Njeh dhe përdor notacionin muzikor bazik për (gjatësitë dhe lartësitë tingëllore (7 tingujt muzikor) për performim dhe krijim e shprehje muzikore. Identifikon dukuritë muzikore ritmike e melodike, në këngët e kënduara dhe në veprat e dëgjuara.	
RNK: I.3, 5. II.7, III.2,3,5. V.8			
RNF: 1.2, 3.4.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Didaktike - nota FA & Nota RE			
Fjalët kyçe: <i>notat muzikore, lartësia e tyre.</i>			
Rezultati i të nxënësve të orës mësimore: Nxënësi: Njeh notat FA dhe RE; Identifikon notat; Këndon sipas lartësisë së notave muzikore.		Kriteret e suksesit: Vizaton ato në pentagram; Emërton notat; Këndon me saktësi.	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukata muzikore, kasetofoni me CD.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuha shqipe; Edukatë figurative; Shoqëria dhe mjedisi, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.			

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Pjesa hyrëse: mësuesi/ja bashkëbisedon me nxënësit lidhur me shkrimin e notave. Mësuesi/ja shpjegon se para se të shkruhen notat muzikore në pentagram, së pari shkruhet çelësi muzikor. Duke kënduar mësuesi/ja dhe duke kërkuar që të jenë më të vëmendshëm, nxënësit vërejnë notën SOL dhe notën MI.

Zhvillimi i mësim: duke dëgjuar CD-në, kalohet në libër përderisa sqarohet dhe komentohen nota SOL dhe nota MI. Tekstet që janë në libër do të lexohen dhe do të komentohen paraprakisht, ndërsa në vazhdim ato do të përvetësohen përmes dëgjimit dhe këndimit.

Mund të merret edhe ndonjë këngë që ata njohin dhe bashkë do të identifikojnë këto nota.

Pjesa përfundimtare: kërkohet nga nxënësit të këndojnë me nota, pastaj edhe me tekst, në grupe pastaj e tërë klasa.

Komentohen tekstet nga nxënësit: „Faji”, „Shoqja e re”, „Notat e muzikës”, „Retë”, për të kuptuar mesazhin e tyre.

Vlerësohen dhe lavdërohen nxënësit për realizimin e orës mësimore

Vlerësimi i nxënësve :

Vlerësim formativ: nxënësi zhvillon të kënduarit me tekst dhe me nota muzikore .

Fusha kurrikulare: Artet	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e Kurrikulës: Shkalla: II	Klasa: IV
Tema nga plani dymujor: Lojërat muzikore		RNT: Luan lojëra të thjeshta muzikore, të shoqëruara me këngë të cilat e kanë gjuhën shprehëse të përshtatshme me fjalorin e moshës së tyre, të përcjella me lëvizje trupore e me vegla muzikore fëmijërore dhe që trajtojnë tema të ndryshme, por edhe elemente didaktike të gjuhës artistike muzikore (ritmi, melodia, vetitë e tingullit muzikor etj.). Luan lojëra të ndryshme ku sinkretizohet fjala, muzika, mimika, lëvizja, ana vizuale etj. (tematika e lojërave përshtatet me tematikat nga fushat e tjera mësimore për këtë klasë).	
RNK: I.5,6. II.8. III.2,3 V.8.			
RNF: 1.1, 2.1, 3.2.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Dinamika & Shëno dinamikën			
Fjalët kyçe: <i>dinamika, forte, piano, mezoforte.</i>			

Rezultati i të nxënësve të orës mësimore: Nxënësi: Njihet dinamikën e muzikës; Identifikon lartësinë e tingujve; Luan lojë.	Kriteret e suksesit: Dallon atë; Emërton lartësinë e tingujve; Luan saktë.
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukata muzikore, kasetofoni me CD.	
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Shoqëria dhe mjedisi; Matematikë; Edukatë figurative.	
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore:	
Pjesa hyrëse: mësuesi/ja bashkëbisedon me nxënësit për tinguj të ndryshëm që dëgjojmë tërë kohën; a janë të zëshëm/fuqishëm, të qetë, të lartë etj. Mësuesi/ja u shpjegon nxënësve se këto në gjuhën muzikore i njohim si: forte (fuqishëm), piano (e qetë), mezoforte (fuqi mesatare) etj. Bëhet fjalë për dinamikën. Gjatë interpretimit, fuqinë e zërit gradualisht mund ta ngrisim - ndryshe quhet dhe njihet si <i>crescendo</i>  ose edhe ta ulim - <i>decrescendo</i> . Zhvillimi i mësimi: që nxënësit ta kuptojnë më mirë, gjeni shembuj për dëgjime muzikore, identifikoni pjesë kur vepra ose kënga kalon nga tingulli i qetë (p) në atë të fuqishëm (f). Luani së bashku: po ashtu, ju mund ta bëni këtë edhe përmes lojës së dirigjentit. Një nga nxënësit mund ta marrë rolin e dirigjentit (udhëheqësit) dhe, përmes shenjave, ai udhëzon korin (nxënësit e tjerë) që të interpretojnë këngën më zëshëm, ose me zë të ulët.	
Pjesa përfundimtare - përsëritet mësimi duke lavdëruar nxënësit për realizimin e orës muzikore.	
Vlerësimi i nxënësve : Vlerësim formativ: nxënësi/ja, në fund të orës identifikon zërat <i>forte</i> (e fuqishëm), piano (të qetë), mezoforte (mesatare) dhe dinamikën e tyre.	

Fusha kurrikulare: Artet	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e Kurrikulës: Shkalla: II	Klasa: IV
Tema nga plani dymujor: Krijimet muzikore		RNT: Improvizon në ritme të ndryshme me zë dhe instrumente ritmike. Ritmizon në mënyrë kreative vargjet, poezitë, gjëegjëzat etj. Realizon plotësimet muzikore (përfundimin e një melodie, pyetje-përgjigje muzikore etj.) Këndon ose luan në instrumente fëmijërore ndonjë krijim origjinal të shkurtër (ritmik, melodik) me inkurajimin dhe ndihmën e mësimeve të mësimdhënësit .	
RNK: I.4, 5,6. II. 5. III.2.5. V.8.			
RNF: 1.1.2.3.8. 2.2. 3.4			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Këngë: Muzikantët e vegjël			
Fjalët kyçe: notat muzikore, teksti, melodia.			
Rezultati i të nxënësve të orës mësimore: Nxënësi: Dëgjon me vëmendje këngën; Mëson tekstin e këngës; Këndon këngën;		Kriteret e suksesit: Komenton tekstin me së paku me dy fjali pas dëgjimit të këngës; Memorizon saktë tekstin; Këndon saktë këngën me ritëm ,intonacion e shprehje artistike	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukata muzikore, kasetofoni me CD.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Shoqëria dhe mjedisi, Njeriu dhe natyra, Edukatë figurative, Gjuha shqipe, Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore:			
Pjesa hyrëse: mësuesi/ja bashkëbisedon me nxënësit për notat muzikore - lartësinë dhe gjatësinë e tyre. Kërkon që të këndojnë dhe përsërisin ato. Nxënësit pyeten se cili është profesioni që do të zgjedhin në një të ardhme. A ka ndonjë nga ata që mendon në një të ardhme t'i qaset profesionit të muzikantit (kompozitor/e, dirigjent/e, instrumentist/e, këngëtar/e).			
Zhvillimi i mësimi: përmes CD-së dëgjohej kënga, hapin librat, komentohet teksti i saj se për çfarë bëhet fjalë dhe pastaj kërkohet nga nxënësit që ta këndojnë strofën e parë, duke dëgjuar melodinë e saj. Kështu vazhdohej derisa të përvetësohet kënga në tërësi, duke kënduar saktë melodinë e këngës.			



Pjesa përfundimtare: këndohet kënga me grupe duke vlerësuar këndimin e nxënësve dhe në fund e tërë klasa këndon së bashku. Lavdërohen nxënësit duke i inkurajuar për mësimin e këngës.
Vlerësimi i nxënësve : Vlerësim formativ: nxënësi/ja, në fund të orës, shqipton drejt tekstin e këngës dhe zhvillohet aftësia dhe ndjenja për ritëm.

Fusha kurrikulare: Artet	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e Kurrikulës: Shkalla: II	Klasa: IV
Tema nga plani dymujor: Veprat artistike Ngjarjet artistike		RNT: Çmon dhe vlerëson performancën/krijimet artistike vetanake dhe të të tjerëve, me fjalor e terma adekuatë. Krijon shprehi: për dëgjim të vazhdueshëm të veprave muzikore dhe për muzikim.	
RNK: I.3, I.4, III.1, III.4.			
RNF: 1.8, 2.1, 3.2, 3.4, 4.1,			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Profesionet: Instrumentisti dhe këngëtari, kompozitori dhe dirigjenti			
Fjalët kyçe: kompozitori, dirigjenti, orkestra, instrumente muzikore.			
Rezultati i të nxënësve të orës mësimore: Nxënësi: Njih orkestrën muzikore; Njih rolin e kompozitorit; Analizon rolin e dirigjentit;		Kriteret e suksesit: Emërton instrumentet muzikore; Përshkruan rolin e kompozitorit; Luan rolin e tij;	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukata muzikore, kasetofoni me CD, interneti.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative.			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore:			
Pjesa hyrëse - mësuesi/ja u shpjegon nxënësve se në botën e muzikës ka profesione të llojllojshme. Ta zëmë, kompozitori ndryshe quhet krijues dhe ai/ajo kompozon vepra/muzikë për fëmijë, vepra të muzikës klasike, muzikë për film etj. Në anën tjetër, dirigjenti/ja mban shkopin në dorë dhe ai/ajo udhëheq korin, orkestrën, ansamblet dhe në njëfarë forme e drejton dhe e udhëheq atë në bazë të notave/partiturave që kompozitori i ka shkruar paraprakisht. Instrumentisti - performon në ndonjë nga instrumentet. Ai/ajo mund të jetë flautist/e, pianist/e, violinist/e, kitarist/e, e kështu me radhë. Instrumentisti ose performuesi luan në instrumentin e tij/saj, në bazë të notave që kompozitori ka shkruar. Instrumentisti mund të jetë solist/e, por edhe pjesë e orkestrës. Këngëtari/ja është solisti/ja i/e cili/a interpreton me zë veprat ose këngët. Ka lloje të ndryshme të zërave: zëra të ulët dhe të lartë.			
Zhvillimi i mësimi: pasi nxënësit të informohen lidhur me profesionet, atëherë në klasë mund të luhet një lojë ku secili nga nxënësit merr ndonjë nga rolet. Dikush do ta zë vendin e dirigjentit i/e cili/a udhëheq korin, dikush do të interpretojë në instrumente muzikore, dikush do të këndojë këngët e mësuara më parë. Kërkoni që të shikojnë me vëmendje lëvizjet (shenjën) se kur të fillojë këndimi, por edhe të kihet kujdes në dinamikën që dirigjenti/ja kërkon. Loja e njëjtë mund të zhvillohet edhe me ndonjë vepër muzikore klasike.			

Pjesa përfundimtare: pyetni nxënësit se në të ardhmen, a do të dëshironin të merreshin me muzikë, të bëheshin kompozitorë ose dirigjentë. Përmes ilustrimit në libër, kërkonin të komentojnë rolin e kompozitorit, instrumentistit dhe dirigjentit.

Vlerësimi i nxënësve: nxënësi/ja në fund të orës njihet me rolin kompozitorit, dirigjentit dhe orkestrës.

Fusha kurrikulare: Artet	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e Kurrikulës: Shkalla: II	Klasa: IV
Tema nga plani dymujor: Këngët		RNT: Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grupe) sipas imitimit dhe nocionit simbolik (grafik). Këngët dhe meloditë e shoqërimet instrumentale trajtojnë tema të ndryshme, të përshtatshme për moshën e tyre (për natyrën, shkollën, familjen, dëshirat, lodrat, stinët, festat etj.). Shoqëron këndimin me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë, sipas instruksioneve të mësimdhënësit dhe në mënyrë kreative.	
RNK: I.4, 6. II. 5,6,7,8. V.8.			
RNF: 1.1.5.8 2.1. 4.1.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Kënga e nënës			
Fjalët kyçe: <i>dashuria, ngrohtësia, lumturia.</i>			
Rezultati i të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: Dëgjon me vëmendje këngën; Mëson tekstin e këngës; Këndon këngën;		Kriteret e suksesit: Komenton tekstin me së paku me dy fjali pas dëgjimit të këngës; Memorizon saktë tekstin; Këndon saktë këngën me ritëm ,intonacion e shprehje artistike	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukata muzikore, kasetofoni me CD.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Shoqëria dhe mjedisi, Njeriu dhe natyra, Edukatë figurative, Gjuha shqipe.			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:			
Pjesa hyrëse: mësuesi/ja pyet nxënësit se si do ta përshkruanin personin me të dashur për ta dhe çka ata vlerësojnë më shumë te ai person.			
Zhvillimi i mësimi: mësuesi/ja lexon vjershën, pastaj nxënësit dëgjojnë këngën nga CD-ja. Gjithashtu mësuesi/ja do të shqiptojë tekstin e këngës me ritmin që ka kënga. Nxënësit, para se ta mësojnë melodinë e këngës, e shqiptojnë tekstin e këngës duke u bazuar në libër.			

Pjesa përfundimtare: këngën e këndon e tërë klasa, dhe pastaj në grupe për të vlerësuar të nxënit (të mësuarit e këngës). I mundësohet edhe ndonjë nxënës/e të provojë të këndojë nëse dëshiron. Gjithashtu, shprehin përshtypjen që kanë për këngën e mësuar, për karakterin dhe për tempin e saj.

Vlerësimi i nxënësve :

Vlerësim formativ: nxënës/ja, në fund të orës, shqipton drejt tekstin e këngës dhe zhvillohet aftësia dhe ndjenja për ritëm.

Fusha kurrikulare: Artet	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e Kurrikulës: Shkalla: II	Klasa: IV
Tema nga plani dymujor: Veprat artistike; Ngjarjet artistike		RNT: Identifikon ndonjë figurë markante nga krijuesit dhe performuesit artistikë botërorë dhe lokalë. Shpreh reagimin personal e emocional ndaj përjetimit të veprës artistike me disa fjali të thjeshta gjatë bisedës dhe vrojtimit, me lëvizje, mimikë, me mjete shprehëse të tjera artistike etj. Çmon dhe vlerëson performancën/krijimet artistike vetanake dhe të të tjerëve me fjalor e terma adekuatë. Krijon shprehi: për dëgjim të vazhdueshëm të veprave muzikore dhe për muzikim. Përshkruan dhe komenton (me forma të ndryshme shprehëse: me gojë, me shkrim, me shprehje figurative, etj.) ndonjë ngjarje muzikore artistike të përjetuar në familje, në shkollë, koncert, nga TV etj.	
RNK: I.3, I.4, I.5, III.1, III.4,			
RNF: 2.1, 3.2, 4.1			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Të dëgjojmë: <i>Simfonia e 5-të e Beethoven-it</i> /Aktivitet: gjeni përgjigjet			
Fjalët kyçe: <i>krijues, performues, instrumente muzikore, vepra artistike.</i>			
Rezultati i të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: Njeh krijuesin muzikor; Dallon veprën artistike; Zhvillon shprehi për dëgjim muzikor.		Kriteret e suksesit: Emërton krijuesin (kompozitorin); Përshkruan ndonjë vepër artistike; Shpreh emocione gjatë dëgjimit muzikor.	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukata muzikore, kasetofoni me CD,			

interneti.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:
Pjesa hyrëse: mësuesi/ja mund të fillojë orën duke u shpjeguar se Beethoven-i është një nga kompozitorët më të njohur në fushën e muzikës. Simfonia e tij e 5-të njihet në gjithë botën, andaj, bashkërisht do të dëgjohet kjo vepër, mirëpo duke e përcjellë grafikën në libër. Në këtë formë do të shihet më mirë vizualisht se si Beethoven-i ka ndërtuar ritmin dhe melodinë. Zhvillimi i mësimi: ilustrimi në libër do t'i ndihmojë ata që të përcjellin veprën. Vepra duhet të dëgjohet me vëmendje dhe të përcillet përmes grafikës, në mënyrë që të kuptohet ritmi dhe vlerat e notave. Përpos që do të vërejnë lehtë vlerat e notave, pra, tingujt e shkurtër dhe të gjatë, gjatë këtij rrugëtimi do ta kuptojnë edhe rëndësinë e dinamikës. Pjesa përfundimtare: komentoni si e kanë përjetuar dëgjimin e veprës artistike të kompozitorit <i>L.V. Beethoven</i>. Aktivitet: gjeni përgjigjet: nxënësit plotësojnë saktë detyrat e dhëna me ndihmën e mësuesit. Vlerësimi i nxënësve: nxënësi/ja, në fund të orës, njihet me rolin e krijuesit (kompozitorit, rolin e dirigjentit dhe të instrumentistëve), krijimet, dinamikën, ngjyrimin dhe tingujt në veprën muzikore. Nxënësi do të fillojë të njohë literaturën e muzikës klasike.

Fusha kurrikulare: Artet	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e Kurrikulës: Shkalla: II	Klasa: IV
Tema nga plani dymujor: Veprat artistike Ngjarjet artistike		RNT: Shpreh reagimin personal e emocional ndaj përjetimit të veprës artistike me disa fjali të thjeshta gjatë bisedës dhe vrojtimit, me lëvizje, mimikë, me mjete shprehëse të tjera artistike etj. Çmon dhe vlerëson performancën/krijimet artistike vetanake dhe të tjerëve me fjalor e terma adekuatë. Krijon shprehi: për dëgjim të vazhdueshëm të veprave muzikore dhe për muzikim. Përkrahet dhe komenton (me forma të ndryshme shprehëse: me gojë, me shkrim, me shprehje figurative, etj.) ndonjë ngjarje muzikore artistike të përjetuar në familje, në shkollë, koncert, nga TV etj.	
RNK: I.3, I.4, I.5, III.1, III.4,			
RNF: 2.1, 3.2, 4.1			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Llojet e institucioneve: Teatri, muzeu, salla koncertale dhe galeria			
Fjalët kyçe: krijues, performues, teatri, muzeu, sallat koncertale, galeria.			
Rezultati i të nxënësve të orës mësimore: Nxënësi: Njeh objektet artistike; Dallon objektet artistike; Zhvillon njohuri për objektet artistike.		Kriteret e suksesit: Emërton objektet artistike; Përkrahet funksionin e tyre; Shpreh emocione gjatë dëgjimit muzikor.	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukata muzikore, kasetofoni me CD, interneti.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore:			
Pjesa hyrëse: ora fillon duke i pyetur nxënësit se sa i njohin dhe sa i vizitojnë institucionet artistike. Pyetni: nëse kanë qenë ndonjëherë në ndonjë koncert, a kanë vizituar ndonjë muze, ndonjë shfaqje në teatër ose galeri. Nëse po, si ka qenë eksperiencia dhe përjetimi i tyre. Le të shpjegojnë se çka kanë parë ose dëgjuar dhe cilat janë mbresat e tyre. Duke dhënë shembuj konkretë, bashkëbisedoni për emrat dhe funksionet e tyre si: teatri, muzeu, sallat koncertale, galeria.			
Zhvillimi i mësimi: kaloni në libër për të shikuar dhe analizuar fotot e dhëna dhe vazhdoni bisedën.			



Gjithashtu, mund të dëgjoni ndonjë vepër përmes internetit, ose të vizitoni virtualisht ndonjë nga muzetë ose teatrot.

Pjesa përfundimtare: pyetni nxënësit se a do të dëshironin të vizitonin teatrin, muzeun, sallat koncertale, galerinë.

Inkurajoni nxënësit që t'i vizitojnë ato, ose të organizoheni bashkërisht dhe të vizitoni ndonjë nga ekspozitat, koncertet ose edhe shfaqjet.

Vlerësimi i nxënësve: nxënësi/ja në fund të orës njihet me fjalët: *teatri, muzeu, sallat koncertale, galeria.*

Fusha kurrikulare: Artet	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e Kurrikulës: Shkalla: II	Klasa: IV
Tema nga plani dymujor: Llojet e muzikës		RNT: Dallon lloje të ndryshme të muzikës në shoqëri përmes dëgjimit muzikor (p.sh muzikë për vallëzim, muzikë për film (vizatimor), muzikë për fëmijë, muzikë për raste të ndryshme, muzikë festive etj.). Identifikon muzikën e përshtatshme për ngjarjet dhe situatat e ndryshme. Përzgjedh muzikën e përshtatshme për ngjarjet dhe situatat e ndryshme, shfaqjet në klasë, shkollë, komunitet etj. Përzgjedh muzikën e përshtatshme për poezitë dhe tregimet e ndryshme.	
RNK: I.4, II.4, III.7.			
RNF: 3.2, 4.1, 4.2.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Llojet e muzikës			
Fjalët kyçe: popullore, klasike, jazz, rock.			
Rezultati i të nxënësve të orës mësimore: Nxënësi: Njeh llojet e muzikës; Analizon zhanret muzikore; Parapëlqen zhanrin muzikor.		Kriteret e suksesit: Emërton së paku tri zhanre muzikore; Numëron së paku tri zhanre muzikore; Përshkruan zhanrin muzikor.	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukata muzikore, kasetofoni me CD, interneti.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative.			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore:			
Pjesa hyrëse: mësuesi/ja pyet nxënësit se çfarë lloj muzike u pëlqen, çfarë muzike dëgjojnë, dhe se si ndihen duke dëgjuar atë. Kërkoni nga nxënësit që të këndojnë ndonjë këngë sipas dëshirës.			
Shpjegojuni nxënësve se edhe muzika ndahet ose dallon sipas tekstit, melodisë, ritmit dhe instrumenteve muzikore. Gjatë orës mund t’u shpjegoni nxënësve termin <i>zhanre muzikore</i> , duke iu sqaruar se muzika mund të jetë e ndryshme dhe se ajo ndahet në zhanre. Ta zëmë, kemi muzikën klasike, operistike, muzikën <i>jazz, rock, vals, hip-hop</i> etj.			
Zhvillimi i mësimi: pas shpjegimit, kaloni në libër duke i komentuar ilustrimet me zhanret muzikore. Mundësisht të dëgjohet ndonjëri nga këto zhanre, për t’i komentuar stilet e të muzikuarit të tyre.			
Pjesa përfundimtare: në fund pyetni nxënësit se cili zhanër muzikor u pëlqeu më shumë e që nuk e kishin dëgjuar më parë. Duke dëgjuar ndonjërin nga zhanret, nxënësit mund të vallëzojnë.			
Vlerësimi i nxënësve: nxënësi/ja në fund të orës dallon zhanret muzikore.			

Fusha kurrikulare: Artet	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e Kurrikulës: Shkalla: II	Klasa: IV
Tema nga plani dymujor: Këngët		RNT: Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grupe) sipas imitimit dhe nocionit simbolik (grafik). Këngët dhe meloditë e shoqërimet instrumentale trajtojnë tema të ndryshme, të përshtatshme për moshën e tyre (për natyrën, shkollën, familjen, dëshirat, lodrat, stinët, festat etj.). Shoqëron këndimin me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë, sipas instruksioneve të mësimdhënësit dhe në mënyrë kreative.	
RNK: I.4, 6. II. 5,6,7,8. V.8.			
RNF:1.1.5. 2.1. 4.1.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Planetët (fq. 74-75)			
Fjalët kyçe: planetët, toka, neptuni, marsi, etj.			
Rezultati i të nxënit të orës mësimore: Nxënësi: Dëgjon me vëmendje këngën; Mëson tekstin e këngës; Këndon këngën;		Kriteret e suksesit: Komenton tekstin me së paku me dy fjali pas dëgjimit të këngës; Memorizon saktë tekstin; Këndon saktë këngën me ritëm ,intonacion e shprehje artistike	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukata muzikore, kasetofoni me CD.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Shoqëria dhe mjedisi, Njeriu dhe natyra, Edukatë figurative, Gjuha shqipe.			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:			
Pjesa hyrëse: mësuesi/ja bashkëbisedon me nxënësit për planetët, duke i pyetur a i njohin ata dhe se cilët janë, çfarë forme kanë, a bën nxehtë ose ftohtë në ta etj. Mund t'i pyesni se ku jetojmë ne dhe se a ka jetë në planetët e tjerë? Kalohet në libër për të komentuar tekstin e këngës dhe për të filluar mësimin e saj.			
Zhvillimi i mësimi: përmes CD-së, dëgjohe kënga, duke i kushtuar kujdes tekstit të këngës dhe ritmit. Kërkohet nga nxënësit që ta këndojnë strofën e parë, duke dëgjuar melodinë e saj. Kështu vazhdohe derisa të përvetësohe kënga në tërësi, duke kënduar saktë melodinë e këngës dhe gjithashtu ritmin.			
Pjesa përfundimtare: këndohet kënga me grupe, duke vlerësuar këndimin e nxënësve, dhe, në fund, e tërë klasa këndon së bashku.			

Lavdërohen nxënësit duke i inkurajuar për mësimin e këngës. Kërkohej që të vizatohen disa nga planetët, duke i emërtuar ata.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësim formativ: nxënësi/ja, në fund të orës, shqipton drejt tekstin e këngës dhe zhvillohet aftësia dhe ndjenja për ritëm.

Fusha kurrikulare: Artet	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e Kurrikulës: Shkalla: II	Klasa: IV
Tema nga plani dymujor: Krijimet muzikore		RNT (nga plani dymujor): Improvizon në ritme të ndryshme me zë dhe instrumente ritmike. Ritmizon në mënyrë kreative vargjet, poezitë, gjëegjëzat etj. Realizon plotësimet muzikore (përfundimin e një melodie, pyetje-përgjigje muzikore etj.). Këndon ose luan në instrumente fëmijërore ndonjë krijim origjinal të shkurtër (ritmik, melodik) me inkurajimin dhe ndihmën e mësimehdhënësit.	
RNK: I.4, 5,6. II. 5. III.2.5. V.8.			
RNF:1.1.2.3.8. 2.2. 3.4			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Kompozitorët e vegjël			
Fjalët kyçe: kompozitori, krijimi, melodia, ritmi, instrumentet.			
Rezultati i të nxënësve të orës mësimore: Nxënësi: Njeh fjalorin muzikor; Emërton rolet e tyre; Krijon modele ritmike.		Kriteret e suksesit: Identifikon emrat; Përshkruan rolin e tyre.; Numëron krijimet e kompozitorit; Performon krijimin e vet.	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukata muzikore, kasetofoni me CD, interneti.			
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore:			
Pjesa hyrëse: mësuesi/ja pyet nxënësit se çfarë kuptojnë me fjalën “kompozitor”, për ta kuptuar se a e kanë mbajtur në mend se çfarë bën kompozitori në botën muzikore. Pasi të merrni përgjigjet, u shpjegoni nxënësve se kompozitori, duke qenë krijues, ai kompozon ose krijon melodi, vepra ose këngë përmes notave muzikore, vlerave të notave e kështu me radhë.			

Zhvillimi i mësim: kaloni në libër duke u shpjeguar nxënësve se çfarë detyre kanë për të bërë. U shpjegoni atyre se në libër duhet të plotësojnë dhe të krijojnë melodi, duke i shfrytëzuar njohuritë e tyre mbi vlerat muzikore. Nxënësit do të tregojnë kreativitet duke marrë rolin e kompozitorit. Ata do të kompozojnë sipas dëshirës. Në këtë mënyrë, duke u bazuar në libër, nxënësit, në mënyrë individuale, do të jenë në gjendje të krijojnë dhe pastaj do të mund t'i luajnë ose këndojnë bashkërisht me nxënësit e tjerë.

Pjesa përfundimtare: pasi të kenë krijuar modele ritmike nxënësit, përpos që ata do të performojnë krijimin e tyre, ato mund të shoqërohen me instrumentet që kanë ose që kanë ndërtuar.

Nxënësit vlerësohen dhe lavdërohen për krijimin dhe performimin e tyre.

Vlerësimi i nxënësve: nxënësi/ja në fund të orës vlerësohet për komponimin e vetëkrijuar dhe performimin.

Fusha kurrikulare: Artet	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e Kurrikulës: Shkalla: II	Klasa: IV
Tema nga plani dymujor: Krijuesit dhe performuesit		RNT: Njeh disa (10) krijues dhe performues nga veprat e dëgjua muzikore.	
RNK: I.3, I.4, I.5, III.1, III.4,			
RNF: 2.1, 3.2, 4.1			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: - Të dëgjojmë: <i>Fahri Beqiri & Vinçenc Gjini</i> - Të dëgjojmë: <i>Giora Feldman “Let’s Be happy”</i>			
Fjalët kyçe: <i>krijues, performues, instrumente muzikore, vepra artistike.</i>			
Rezultati i të nxënësve të orës mësimore: Nxënësi: Njeh krijuesin muzikor; Dallon veprën artistike; Zhvillon shprehje për dëgjim muzikor.		Kriteret e suksesit: Emërton krijuesin (kompozitorin); Përshkruan ndonjë vepër artistike; Shpreh emocione gjatë dëgjimit muzikor.	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukata muzikore, kasetofoni me CD, interneti.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore:			
Pjesa hyrëse: filloni orën mësimore duke pyetur nxënësit nëse u kujtohet instrumenti <i>klarineta</i> , dhe se			

cilës familje i takon, pra, a është instrument me tel, a është me frymë, a është i drurit apo i tunxhit? “A ju kujtohet tingulli i tij dhe me cilin instrument tjetër ngjason?”.

Diskutoni lidhur me prezencën e klarinetës në orkestra, por edhe për faktin se instrumenti i klarinetës përdoret (e gjejmë) edhe në muzikën klasike, edhe në atë popullore.

Zhvillimi i mësimi: pyetni nëse kanë dëgjuar për krijuesit tanë: Fahri Beqiri dhe Vinçenc Gjini. Autorët tanë kanë shkruar shumë vepra për klarinetën, por si shembuj do t’i dëgjojnë dy nga kompozitorët tanë dhe një nga një kompozitor i huaj që quhet *Giora Feldman*.

Fahri Beqiri dhe Vinçenc Gjini i takojnë gjeneratës së parë të kompozitorëve tanë profesionistë. Kanë shkruar vepra orkestrale dhe solistike. Kompozimet e tyre për klarinetë pasurojnë thesarin tonë muzikor.

Pjesa përfundimtare: pyetni nxënësit se a iu pëlqyen këta shembuj muzikorë dhe se cili është mendimi i tyre për klarinetën. Si tingëllon ajo në muzikën klasike; po në atë popullore? Ku vërehet më mirë karakteri i saj, në cilën zhanër?

Vlerësimi i nxënësve: nxënësi/ja, në fund të orës, njihet me rolin e krijuesit (kompozitorit dhe të instrumentistëve, performuesve), krijimet, dinamikën, ngjyrimin dhe tingujt në veprën muzikore. Nxënësi do të fillojë të njohë literaturën e muzikës klasike.

Fusha kurrikulare: Artet	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e Kurrikulës: Shkalla: II	Klasa: IV
Tema nga plani dymujor: Lojërat muzikore		RNT: Luan lojëra të thjeshta muzikore, të shoqëruara me këngë, të cilat e kanë gjuhën shprehëse të përshtatshme me fjalorin e moshës së tyre, të përcjella me lëvizje trupore e me vegla muzikore fëmijërore dhe që trajtojnë tema të ndryshme, por edhe elemente didaktike të gjuhës artistike muzikore (ritmi, melodia, vetitë e tingullit muzikor etj.). Luan lojëra të ndryshme ku sinkretizohet fjala, muzika, mimika, lëvizja, ana vizuale etj. (tematika e lojërave përshtatet me tematikat nga fushat e tjera mësimore për këtë klasë).	
RNK: I.3, 2.4, III.2, III.4, III.7.			
RNF:1.6, 2.1,			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Kanoni			
Fjalët kyçe: <i>kanoni, imitimi.</i>			

Rezultati i të nxënësve të orës mësimore: Nxënësi: Njeh fjalën kanon; Imiton mësuesen/in; Identifikon tingujt e dëgjuar.	Kriteret e suksesit: Shpjegon fjalën kanon; Imiton mësuesen/in saktë; Diferencon notacionin e tingujve.
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukata muzikore.	
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative.	
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore:	
Pjesa hyrëse: u shpjegoni nxënësve fjalën “kanon”, duke iu treguar se, nëse melodinë e njëjtë e këndojnë ose e luajnë dy grupe, me ç'rast njëri fillon me vonesë, do ta fitojmë kanonin. Zhvillimi i mësimet: pasi nxënësit të kuptojnë detyrën (punën) që kanë për të bërë, kaloni në libër për të realizuar lojën. Së pari mësuesi/ja këndon me notat e dhëna në partiturë, pastaj kërkoni që të njëjtën ta përsërisin nxënësit. Pjesa përfundimtare: nxënësit do të përsërisin ushtrimin derisa ta përvetësojnë duke imituar; interpretojnë bashkë me shoqet dhe shokët. Nxënësit do të vlerësohen dhe lavdërohen për angazhimin e realizimit të orës mësimore.	
Vlerësimi i nxënësve: nxënësi/ja në fund të orës këndon notat muzikore dhe mëson se si realizohet kanoni.	

Fusha kurrikulare: Artet	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e Kurrikulës: Shkalla: II	Klasa: IV
Tema nga plani dymujor: Krijimet muzikore		RNT: Improvizon në ritme të ndryshme me zë dhe instrumente ritmike. Ritmizon në mënyrë kreative vargjet, poezitë, gjëegjëzat etj. Realizon plotësimet muzikore (përfundimin e një melodie, pyetje-përgjigje muzikore etj.). Këndon ose luan në instrumente fëmijërore ndonjë krijim origjinal të shkurtër (ritmik, melodik) me inkurajimin dhe ndihmën e mësimeve.	
RNK: I.3, I.4, I.5, III.1, III.4,			
RNF: 2.1, 3.2, 4.1			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Përgatitni koncert në klasën tuaj			
Fjalët kyçe: programi, nxënësit, paraqitja skenike.			
Rezultati i të nxënësve të orës mësimore: Nxënësi: Njih krijuesit e arteve; Dallon veprën artistike; Njih objektet e paraqitjes së arteve.		Kriteret e suksesit: Emërton krijuesin (kompozitorin); Përshkruan ndonjë vepër artistike; Emërton dhe numëron ato.	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukata muzikore, kasetofoni me CD, interneti.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Shoqëria dhe mjedisi, Gjuhë shqipe; Edukatë figurative.			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore:			
Pjesa hyrëse: mësuesi/ja pyet nxënësit se a u pëlqejnë programet shkollore që shfaqen për festa të shumta. A do të donin që edhe ata të përgatisin një program? Si fillim, do të ndahen rolet. Dikush do të këndojë, dikush do të luajë në instrumente, dikush do të recitojë etj. Kaloni në libër për disa nga këshillat.			
Zhvillimi i mësimi: pasi t'i kenë marrë këshillat nga libri, ndani nxënësit në grupe punuese, duke iu ndarë rolet e punës sipas shkathtësive që kanë, duke përfshirë të gjithë. Nxënësit do të fokusohen në libër për të ndarë rolet sipas radhitjes së programit.			
Pjesa përfundimtare: nxënësit paraqesin programin në pika të shkurtra. Vlerësohen dhe lavdërohen për punën ekipore dhe programin. Shprehin emocionet që patën dhe punën që bënë.			
Vlerësimi i nxënësve: nxënësi/ja në fund të orës krijon zhvillimin dhe dëshirën për t'u marrë me muzikë, recitim ose ndonjë formë tjetër, për realizimin e programeve edhe në shkollë.			

Fusha kurrikulare: Artet	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e Kurrikulës: Shkalla: II	Klasa: IV
Tema nga plani dymujor: Këngët		RNT: Këndon dhe interpreton në instrumente (individualisht dhe në grupe) sipas imitimit dhe nocionit simbolik (grafik). Këngët dhe meloditë e shoqërimet instrumentale trajtojnë tema të ndryshme, të përshtatshme për moshën e tyre (për natyrën, shkollën, familjen, dëshirat, lodrat, stinët, festat etj.). Shoqëron këndimin me zë, me duar dhe me vegla muzikore ritmike për fëmijë, sipas instruksioneve të mësimdhënësit dhe në mënyrë kreative.	
RNK: I.3.4, 6. III. 2,4,5,. V.8. VI.2			
RNF: 1.1,5. 2.1. 4.2			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Kënga “Lamtumirë”			
Fjalët kyçe: viti shkollor, qershori , pushimet e verës.			
Rezultati i të nxënësve të orës mësimore: Nxënësi: Dëgjon me vëmendje këngën; Mëson tekstin e këngës; Këndon këngën;		Kriteret e suksesit: Komenton tekstin me së paku me dy fjali pas dëgjimit të këngës; Memorizon saktë tekstin; Këndon saktë këngën me ritëm ,intonacion e shprehje artistike	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukata muzikore, kasetofoni me CD.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Shoqëria dhe mjedisi, Njeriu dhe natyra, Edukatë figurative, Gjuha shqipe.			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore:			
Pjesa hyrëse: mësuesi/ja pyet nxënësit se si kaluan këtë vit shkollor, a janë të lumtur, sa kanë mësuar dhe a janë të kënaqur me suksesin. Pyet nxënësit se si do t’i kalojnë pushimet e verës. Inkurajoni që të dëgjojnë muzikë dhe të lexojnë ndonjë libër. Në vazhdim, kalohet në libër për ta lexuar tekstin e këngës. Zhvillimi i mësim: mësuesi/ja lexon vjershën dhe bashkë me nxënësit komenton strofat e saj. Në vazhdim, dëgjojnë këngën nga CD-ja. Mësuesi/ja shqipton tekstin e këngës me ritmin që ka kënga. Nxënësit, edhe një herë, para se ta mësojnë melodinë e këngës, e shqiptojnë tekstin e këngës, duke u bazuar në libër. Fillojnë të këndojnë këngën duke e dëgjuar CD-në, ose me përcjelljen e pianos disa herë. Këngën e këndon e tërë klasa, pastaj në grupe për të vlerësuar të nxënësve (të mësuarit e këngës). Pjesa përfundimtare: në fund, nxënësit japin përshtypjet e tyre për këngën e mësuar, për karakterin dhe për tempin e saj. Nxënësit paraqesin pamje të pushimeve të verës, duke vizatuar dhe ngjyrosur.			
Vlerësimi i nxënësve : Vlerësim formativ: nxënësi/ja, në fund të orës, shqipton drejt tekstin e këngës dhe zhvillohet aftësia dhe ndjenja për ritëm.			

Fusha kurrikulare: Artet	Lënda: Edukatë muzikore	Shkalla e Kurrikulës: Shkalla: II	Klasa: IV
Tema nga plani dymujor: Instrumentet muzikore		RNT: Identifikon dhe dallon instrumentet muzikore edhe vizualisht. Krijon instrumente muzikore ritmike me materiale ricikluese dhe organike (marakas me oriz, misër, dajre të vogla etj.)	
RNK: II.1, II.2, II.5, III.1, III.7.			
RNF: 1.2, 1.3, 2.4,			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Të ndërtojmë instrumente muzikore			
Fjalët kyçe: <i>Instrumente muzikore, sajime, tinguj, rima, riciklime.</i>			
Rezultati i të nxënësve të orës mësimore: Nxënësi: Jep ide për materialet ricikluese; Krijon instrumente muzikore me materiale ricikluese; Luan me instrumente.		Kriteret e suksesit: Përzgjedh iden për materialet ricikluese; Krijon një instrument me materialin e përzgjedhur; Luan me ritëm me instrumentin e krijuar.	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Edukata muzikore, kasetofoni me CD.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë, Gjuhë shqipe, Arsimim për zhvillim të qëndrueshëm.			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtarisë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore:			
Pjesa hyrëse: mësuesi/ja bashkëbisedon me nxënësit se si edhe ata mund të ndërtojnë instrumente muzikore (duke shpërfaqur kreativitetin) dhe të fitojnë tinguj të ndryshëm. Kaloni në libër duke shikuar dhe komentuar fotografitë ku shfaqen instrumentet e krijuara me gjësende të ndryshme. Këto instrumente, fare lehtë mund të krijohen edhe nga nxënësit. Mësuesi/ja paraprakisht njofton nxënësit se çfarë duhet marrë (siguruar) për realizimin e orës mësimore, si; kapakë metali dhe kapakë plastike të shisheve, kartonë kuzhine, arra, çelësa të vjetër, penj ngjitës etj., ku përmes tyre do të ndërtohen instrumente, të cilat krijojnë tinguj të ndryshëm.			
Zhvillimi i mësimit: jepuni kohë nxënësve që të mendojnë dhe të vijnë me ide të reja. Krijoni edhe instrumente të tjera, varësisht dëshirës. Kërkoni që nxënësit të ritmizojnë në mënyrë të koordinuar ndonjë ritëm dhe në të njëjtën kohë shoqëroni këngët e mësuara më parë.			
Pjesa përfundimtare: të performojë nxënësi/ja në mënyrë individuale.			
Pyetni nxënësit se a u pëlqeu modeli i mjeteve ricikluese për të fituar tinguj dhe ritme, duke nxitur ata që sa më bukur dhe qartë të shprehën. Vlerësoni dhe lavdëroni nxënësit për realizimin e këtij aktiviteti.			
Vlerësimi i nxënësve: nxënësi/ja në fund të orës vlerësohet për kreativitetin dhe për sajimin e instrumenteve muzikore të tingujve (rimave) nga gjësendet ricikluese.			